



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në “Bashkinë Kuçovë”

RAPORT

(Auditim Financiar)

BASHKIA KUÇOVË

Tiranë, 2024

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITULJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 – 5
	<i>a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.</i> <i>b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.</i> <i>c. Qëllimi i auditimit</i> <i>d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.</i> <i>e. Nga shqyrtimi i evidencave,</i> <i>f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.</i> <i>h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:</i>	
I.1	KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT	5 – 6
II.	HYRJA,	6-12
1.	OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA	7– 12
	<ul style="list-style-type: none"> -Objektivat e Qëllimi auditimit -Identifikimi i çështjes -Përgjegjësitë e strukturave drejtuese e audituesve -Kriteret e vlerësimit -Standardet e auditimit -Metodat e auditimit -Dokumentimi i auditimit 	
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12-67
2.1	<i>Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.</i>	<i>12 – 18</i>
2.2.	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	<i>18 – 24</i>
2.2.5	<i>Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.</i>	<i>24 – 39</i>
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	<i>39 – 51</i>
2.3.4	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave)të transferuara sipas VKM.</i>	<i>51-54</i>
2.4	<i>Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</i>	<i>54-67</i>
2.5	<i>Të ndryshme të dala gjatë auditimit</i>	
III.	GJETJE DHE PËR KËTË REKOMANDOJMË.....	67-- 80
IV.	ANEKSE.	81 – 104

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI-t	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Zona Gjeografike: Bashkia Kuçovë kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Belsh, në lindje me Bashkinë Gramsh, në jug me Bashkinë Berat dhe në perëndim me Bashkinë Dimal. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Kuçovës. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative.

Misioni i Bashkisë Kuçovë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Kuçovë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kuçovë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Kuçovë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM
- mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve,

janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 20 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime, nga ku masa organizative me 15 gjetje dhe 15 rekomandime, 4 gjetje dhe 5 rekomandime, për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara dhe 1 gjetje dhe një rekomandim për debitorët nga taksat e tarifave vendore.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Procedurat e ndjekura për zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 120/9 prot., datë 30.06.2023, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej 73 rekomandime, të cilat janë pranuar 73 plotësisht ose në masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga 73 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 24 prej tyre ose 32.88%, zbatuar pjesërisht 2 masa ose 2.74% e totalit të masave të pranuar, në proces zbatimi 4 masa ose 5.48%, dhe **pa zbatuar rezultuan 43 masa ose 58.90%.**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej 22 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht ose në masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga 22 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 7 prej tyre ose 31.82%, në proces zbatimi 8 masa ose 36.36% dhe **pa zbatuar rezultuan 7 masa ose 31.82%**

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.

- Të ardhura të munguara në vlerën 23,447,723 lekë nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.

- Të ardhura të munguara në vlerën 13,586,066 lekë nga mos arkëtimi i detyrimeve nga dhënia me qira e tokave bujqësore të pandara nga 93 fermerë në vlerën 13,586,066 lekë.

- Të ardhura të munguara në vlerën 800,000 lekë nga mos arkëtimi i tarifës së autorizimit për ushtrim aktiviteti tregtimi hidrokarbure dhe derivatet e tyre nga 4 subjekte të pa licencuara.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat për bizneset, institucione dhe familjare prej 98,362,721 lekë.

-Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve

Nga auditimi rezultoi se nga 3504 prona që i janë transferuar në pronësi Bashkisë Kuçovë, përfshirë ish-komunat (Perondi, Kozare dhe Lumas), vetëm 118 pasuri janë regjistruar.

I.1.KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kuçovë për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Kuçovë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që

*në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinion:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA¹⁶). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Kuçovë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 21,259 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën 23,447,723 lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.

-Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 202 “Studime dhe projekte”, është mbivlerësuar për vlerën 6,235,200 lekë për projekt të vënë në zbatim si dhe vlera prej 1,359,400 lekë e trashëguar nga ish Komunitat sot Njësiti Administrative, janë të paanalizuara dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim.

-Nga auditimi ka rezultuar se është kontabilizuar gabim vlera prej 7,992,306 lekë për sistemim varrezash që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 210 “Toka, troje Terrene”

-Nga auditimi ka rezultuar se llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, nuk është zbritur vlera për 2 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 28,866,405 lekë që janë transferuar UK Kuçovë.

-Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk është pasqyruar në kontabilitet vlera prej 3,500,000 lekë pjesë e aksioneve të Klub Sport “N”.

-Për vitin 2023, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 2 raste në vlerën 15,442,402 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 360/1 prot., datë 13.03.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 18.03.2024 deri në datë 12.04.2024, në subjektin Bashkia Kuçovë, për periudhën nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023, u krye auditimi me objekt “Mbi auditimin financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. P.GJ, Përgjegjës Grupi
2. R.A, anëtarë,

3. E.K, anëtarë,

1.OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat e auditimit.

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Kuçovë kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Qëllimi i auditimit.

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Kuçovë, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Identifikimi i çështjes.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kuçovë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

-Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

-Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

-Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.

-Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave)të transferuara sipas VKM.

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kuçovë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionimi i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Kuçovë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit.

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Kuçovë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Peqin. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

- ✓ Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- ✓ VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”
- ✓ V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- ✓ V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- ✓ Udhëzimi MF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- ✓ Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, dt. 16.10.2017.
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike
 - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
 - Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
 - Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
 - Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
 - Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

Standardet e auditimit.

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Kuçovë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ✓ ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

Metodat e auditimit.

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Peqin me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

▪ Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

▪ Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; nëobsevime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Dokumentimi i auditimit. Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Kuçovë, pasi nga grupi i auditimit janë reflektuar observacionet e ardhura në fazën e aktkonstatimeve të cilat kanë ardhur me vonesë me shkresën nr. 945/12, datë 19.04.2024 (prot KLSH nr. 360/2, datë 22.04.2024), nr. 945/13, datë 19.04.2024 (prot KLSH nr. 360/3, datë 22.04.2024) dhe nr. 945/14, datë 19.04.2024 (prot KLSH nr. 360/4, datë 22.04.2024) si dhe nga subjekti i audituar me shkresën nr. 945/17, datë 29.05.2024 (prot KLSH nr. 360/6, datë 31.05.2024), është kthyer Projekt Raporti i Auditimit me observacione, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 360/5, datë 29.04.2024. Gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Auditim, i cili i përcillet subjekti për zbatim dhe përmisimin e gjendjes në të ardhmen, referuar kjo dhe rekomandimeve të KLSH të reflektuara në fund të raportit.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Pika 1.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kuçovë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: "Mjedisi i Kontrollit", "Menaxhimi i Riskut", "Aktivitetet e Kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi" si dhe "Monitorimi", sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin.

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

Në lidhje me parimin 1: "Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".

- Në vitin 2018 është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Kuçovë. Nga ana formale, kjo rregullore ka vetëm firmën e Kryetarit dhe vulën e institucionit, por nuk ka numër protokolli dhe nuk është e miratuar në Këshillin Bashkiak.

-Me nr. 11 prot, datë 04.01.2023 është miratuar Kodi i Etikës, ku ndër të tjera përcaktohen parimet bazë për shmangien e konfliktit të interesit dhe të ndalimit të shpërdorimit të detyrës.

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisve, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjisllacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Marrëdhëniet e punës vlerësohen në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore edhe për punonjësit, marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me Kod Pune;

Në lidhje me parimin 2: *“Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.*

- Për vitin 2023 nuk ka plan-veprimi për MFK ku të përfshihen aktivitetet të planifikuara, afatet e realizimit dhe strukturat përgjegjëse për përmbushjen e tyre.

Në lidhje me parimin 3 *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.*

Me vendimin nr. 01 datë 12.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë, në zbatim të VKB nr.81 datë 22.12.2022 “Për kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar si dhe të administratës” është miratuar struktura administrative e bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë për vitin 2023. Në këtë strukturë janë bërë tre ndryshime përgjatë periudhës objekt auditimi:

Me Vendimin nr. 21 datë 11.04.2023 është ndryshuar emërtimi i sektorit të koordinim-zhvillimit dhe i integritit evropian” në “Sektori i Koordinim-Zhvillimit, Integritit Evropian dhe Diasporës”.

Me Vendimin nr. 36 datë 26.09.2023 është ndryshuar emërtimi “specialist finance” në “specialist për ndihmën dhe PAK”.

Me Vendimin nr. 40 datë 26.10.2023 janë bërë ndryshime në emërtesa duke krijuar emetimin e ri “topograf” dhe “specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Numri i përgjithshëm i punonjësve për vitin 2023 ka ndryshuar nga 394 në 400 punonjës, nga të cilat 10 vende janë në vakantë.

Struktura Organizative e Bashkisë Kuçovë, e ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi ka pasur disa ndryshime. Rregullorja e bashkisë nuk reflekton ndryshimet në strukturë/funksione që ka pësuar Bashkia Kuçovë pas vitit 2018.

Në lidhje me parimin 4: *“Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.*

- Në Bashkinë Kuçovë, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, me qëllimin rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve në ushtrimin e kompetencave përkatëse.

- **Në lidhje me parimin 5:** *“Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.*

Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS):

Me Urdhrin nr. 118 datë 22.05.2023 në Bashkinë Kuçovë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik ku Kryetar i GMS është Kryetari i Bashkisë dhe janë përfshirë të gjithë nivelet drejtuese.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij;

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësive publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij komponenti, titullari i njësive publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

Në lidhje me parimin 6: “*Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre*”.

- Nga Bashkia Kuçovë përcaktohen objektiva sasiorë (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk ka plane operacionale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Kuçovë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore*”.

Në lidhje me parimin 7: “*Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*”.

- Në Bashkinë Kuçovë është hartuar regjistri i riskut për vitin 2023, por nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut;

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

- Bashkia Kuçovë administron në *excel* regjistrin e riskut, ku jepet informacion mbi përshkrimin e riskut, risku para kontrollit, kontrollat ekzistuese, risku pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle shtesë, veprimet për të adresuar riskun dhe struktura përkatëse për të ndërmarrë këto veprime.

Sa më sipër konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendosë kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar.

Në lidhje me parimin 8: “*Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim*”.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarive mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: “*Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm*”.

- Bashkia Kuçovë në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni apo nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për t’i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme. Si rrjedhojë, Bashkia Kuçovë nuk ka një sistem të plotë të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 10: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli*”.

- Në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.);

Në lidhje me parimin 11: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*”.

- Bashkia Kuçovë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar infrastrukturë IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Në rregulloren e brendshme nuk përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe ka

vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterat e bashkisë;

- Në Bashkinë Kuçovë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish;

Në lidhje me parimin 12: “*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave*”.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesa të funksioneve.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listëpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, të cilat më pas kontrollohen.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “*Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor*”.

Bashkia Kuçovë disponon faqen e saj zyrtare në internet, <https://bashkiaKuçovë.gov.al>, ku pasqyrohet pjesërisht aktiviteti i bashkisë.

Në lidhje me parimin 14: “*Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor*”.

-Procedurat për të siguruar që menaxherët dhe personeli i njësisë publike të informohen për vendimet/projektet/nismat e njësive të tjera, që mund të ndikojnë në përgjegjësitë dhe detyrat e tyre përfshijnë komunikime përmes e-maileve dhe mbledhjeve. Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

Në lidhje me parimin 15: “*Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm*”.

- Është konstatuar se në faqen ueb të Bashkisë Kuçovë mungojnë:

Buxheti për vitin 2023;

Kalendari vjetor i dëgjësave publike;

Regjistri i akteve të Këshillit Bashkiak;

Regjistri i projekt-akteve për konsultim publik;

Raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2023.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: “*Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme*”.

- Në Bashkinë Kuçovë mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH;

- Në Bashkinë Kuçovë aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe janë pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmerisë, efektiviteti i shërbimeve publike i shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Në lidhje me parimin 17: “*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë*”.

-- Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dërguar planin e veprimit me nr. 385 prot, datë 21.07.2023 për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Konstatimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, është pjesërisht efektiv, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i Kontrollit”

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Për vitin 2023 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
- Nga ana formale, rregulloja ka vetëm firmën e Kryetarit dhe vulën e institucionit, por nuk ka numër protokolli dhe nuk është e miratuar në Këshillin Bashkiak. Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në Bashkinë Kuçovë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

“Menaxhimi i Riskut”

- Bashkia Kuçovë nuk ka ngritur grupin e menaxhimit të riskut, përfshirë koordinatorin si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Kuçovë.
- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Kuçovë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.
- Në Bashkinë Kuçovë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Në Bashkinë Kuçovë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe programin Alpha Buxhetor. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

“Informimi dhe Komunikimi”

- Është konstatuar se në faqjen ueb të Bashkisë Kuçovë mungojnë:
 - Buxheti për vitin 2023;
 - Kalendari vjetor i dëgjësive publike;
 - Regjistri i akteve të Këshillit Bashkiak;
 - Regjistri i projekt-akteve për konsultim publik;
 - Raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2023

“Monitorimi dhe Raportimi”

- Në Bashkinë Kuçovë mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

1.2. Mbi organizimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm.

Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 81 datë 22.12.2022 dhe ka në përbërje 3(tre) punonjës, 1(një) Përgjegjës i Sektorit të A.B dhe 2(dy)

specialiste auditimi që ende nuk janë certifikuar. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Kuçovë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartën e Auditimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 47, me nr. 659 prot., datë 24.02.2022.

Struktura e njësisë së auditimit të brendshëm për vitin 2023

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajni me të vijueshme
	Për vitin 2022							
1	A.C	P/Njësisë	13.12.21	Master Prof. Ekonomi	25	2	Po	Po
2	E.F	Specialiste	05.01.21	Master Prof. Juridik	7	3	Jo	Po
3	E.L	Specialiste	12.12.22	Master Prof. Ekonomi	1	1	Jo	Po

1.2. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, për vitin 2023 është miratuar plani vjetor i auditimeve miratuar me dokumentin nr. 3218 prot., datë 19.10.2022 si dhe është përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE. Në këtë plan kanë qenë të programuara 6(gjashtë) angazhime auditimi gjithsej sipas tabelës vijuese:

Nr	Auditime	Planifikuar	Jashtë Planit	Realizimi i angazhimeve të auditimit				
				Përputhsh	Performcë	Financ	IT	Kombin.
1	Njësia Administrative Kozare	Po		X				
2	Njësia Administrative Lumas	Po		X				
3	Drejtoria e Zhvillimit Rural, Kontrollit të Ushqimit e Veterinar	Po		X				
4	Qendra Ekonomike e Arsimit	Po		X				
5	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Po		Nuk është realizuar				
6	Spektori i Koordinimit-Zhvillimit Strategjik dhe Integritimit European	Po		Nuk është realizuar				
7	Spektori i prokurimeve		Po	X				1
		6	1	5	0	0	0	1

Burimi: NJAB Kuçovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në lidhje me zbatimin e planit vjetor rezulton se nga 6 auditime të planifikuara gjithsej, nuk janë realizuar 2 auditime përkatësish në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Sektorin e Koordinimit-Zhvillimi Strategjik dhe Integritimit Evropian. Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me nr. 113, datë 09.05.2023, Njësia e Auditimit të Brendshëm u angazhua **në një auditim jashtë planifikimit të vitit 2023**, në subjektin “Spektori i Prokurimit Publik pranë Drejtorisë Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, kjo në përputhje me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” nenit 3 pika b, dhe nenit 14 pika a, dhe në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III dhe IV, si dhe në vlerësim të kërkesës së bërë nga subjekti donator i fondit në dispozicion.

Për aktivitetin e vitit 2023 rezulton se:

Është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 253/1 prot., datë 13.02.2023.

Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Karta e auditimit të brendshëm është miratuar nga Titullari i Bashkisë Kuçovë me urdhrin nr. 47 prot., datë 24.02.2022.

Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2023 rezulton se janë dhënë 44 rekomandime gjithsej, por nuk është realizuar një auditim i posaçëm mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve. Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2023	44			44				
TOTALI		44							

Burimi: NJAB Kuçovë

Rekomandime për përmirësimin e sistemeve janë propozuar 12 masa dhe janë kryesisht të njohjes dhe të zbatimit nga strukturat e audituara të kriterëve dhe kërkesave ligjore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rekomandime me karakter organizativ janë propozuar 19 masa.

Rekomandime të tjera janë propozuar 13 masa.

Konstatimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

-Në auditimet e kryera për vitin 2023, konstatohet se Sektori i Auditit të Brendshëm (AB) nuk ka kryer auditime me bazë risku, duke planifikuar auditime për sektorin e prokurimeve si dhe nuk ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme;

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2023, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

Pika 2.1 e programit. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Programimi i PBA 2023-2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr. 92, datë 23.04.2019, (i ndryshuar me Urdhër nr. 118, dt. 22.05.2023) të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 17, datë 25.03.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 257/1, datë 01.04.2022. Tavanet përfundimtare janë miratuar me VKB nr. 46, datë 24.08.2022 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr. 2756, datë 07.09.2022.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 15 - programe buxhetore, të dhënat në pasqyrën **Aneks nr. 1/2, bashkëlidhur.**

Ndërsa ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga 600	225,915	42.33	225,915	42.81	231,058	42.79
2	Sig. 601	38,254	7.17	38,254	7.25	39,052	7.23
3	Shpenzime operative 602	136,842	25.64	140,307	26.59	136,390	25.26
4	Shpenzime604	4,371	0.82	900	0.17	900	0.17
5	Shpenzime606	11,732	2.20	11,732	2.22	11,732	2.17
6	Shpenzime609	3,884	0.73	10,948	2.07	11,974	2.22

7	Investime 230-231	112,658	21.11	99,687	18.89	108,898	20.17
	Total	533,656	100	527,743	100	540,005	100

Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:
Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

A	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	76,089	76,089	76,089
2	Jo tatimore	151,270	133,970	133,970
I	Totali	227,359	210,059	210,059
1	Transferta e pakushtëzuar	179,657	191,044	203,306
2	Transfertë specifike	126,640	126,640	126,640
II	Shuma e transfertave	306,297	317,684	329,946
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)	0	0	0
	Totali i burimeve të veta (I +II+III)	533,656	527,743	540,005

Për vitin 2023 buxheti është miratuar me VKB nr. 82, datë 22.12.2022 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 956/2 prot., datë 09.01.2023.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë për vitin 2023 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
	Të ardhurat	580,152	
1	Transferta e pakushtëzuar	201,616	
2	Të ardhurat e veta	225,188	
3	Transfertë specifike	128,261	
4	Të ardhura të trashëguara	25,087	
	Shpenzimet		580,152
1	Paga 600		235,114
2	Sig. 601		39,522
3	Shpenzime operative 602		158,381
4	Shpenzime604		5,465
5	Shpenzime606		11,438
6	Shpenzime609		11,578
7	Investime 230-231		118,654
	Totali i buxhetit	580,152	580,152

Nga krahasimi i buxhetit të miratuar në vlerën 580,152 mijë lekë me atë sipas PBA 2023-2025 në vlerën 533,656 rezulton se kemi rritje në vlerën 46,496 mijë lekë e cila vjen si rezultat i rritjes së shpenzimeve në artikullin Paga në vlerën 9,199 mijë lekë, sigurime shoqërore në vlerën 1,268 mijë lekë, shpenzime operative në vlerën 21,539 mijë lekë, transferta në vlerën 8,494 mijë lekë dhe investime në vlerën 5,996 mijë lekë.

Buxheti i miratuar me VKB nr. 82, datë 22.12.2022, është dërguar në MFE me shkresën nr 96, datë 19.01.2023

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 354,964 mijë lekë (Të ardhura të vitit në shumën 128,261 mijë lekë, të trashëguara të vitit paraardhës në shumën 25,087 mijë lekë dhe grandit 201,616 mijë lekë) ose në masën 61 %, dhe transferta specifike në shumën 225,188 mijë lekë ose në masën 39 %.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2022 shpenzimet për paga e sigurime zënë 47 % ose në vlerën 274,636 mijë lekë, shpenzime korrente zënë 28 % ose për vlerën 158,381 mijë lekë, transferta zënë 5% ose për vlerën 28,481 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 20 % ose në vlerën 118,654 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar me VKB nr. 81, datë 22.12.2022, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 956/2, datë 09.01.2023, ku janë planifikuar 400 punonjës dhe në fakt për vitin 2023 kanë punuar 375 punonjës.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 81 datë 22.12.2022 në zbatim të VKM nr. 177, datë 08.03.2017, “Për disa ndryshime në VKM nr. 165, datë 02.03.2016”

Paketa fiskale për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 73, datë 30.11.2022.

Të ardhurat gjithsej për të financuar buxhetin e vitit 2023, janë planifikuar në vlerën 225,188 mijë lekë dhe në fakt janë realizuar në vlerën 210,445 mijë lekë.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare dhe ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, për vitin 2023 buxheti shtesë gjithsej është në **vlerën 624,253 mijë lekë**, e analizuar si më poshtë:

1. Shtesë plani sipas VKB nr. 04, dt. 21.01.2023 në shumën 40,976 mijë lekë nga e ardhura e trashëguar dhe 718 mijë lekë financim i pritshëm nga buxheti me shkresë nr. 2960 dhe 296/1 dt.19.11.2020.
2. Sistemim plani në buxhet, VKB nr. 20, dt. 21.04.2023 pakësim i fondit rezervë 8,341 mijë lekë dhe shtesë plani për paga dhe sigurime për efekt të pagës minimale dhe shtesë plani për investime 255 mijë lekë, financim i pritshëm nga donatorë.
3. Shtesë plani nga Ministria e Mbrojtjes sipas VKB nr. 08, dt. 21.07.2023 në shumën 43,215 mijë lekë për mbrojtjen civile.
4. Shtesë plani nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për investime në shkolla sipas VKB nr. 09, dt. 21.07.2023 në shumën 32,204 mijë lekë, me shkresë nr. 3124/5 dt. 09.06.2023.
5. Shtesë plani e transfertës specifike për rritje pagash sipas VKB nr. 10, dt. 21.07.2023 në shumën 5,397 mijë lekë dhe funksioneve të deleguara në shumën 6,853 mijë lekë, me shkresë nr. 1548/2 dt. 23.02.2023, nr. 1849 dt. 10.05.2023, nr. 1404 dt. 24.04.2023, nr. 1609 dt. 11.05.2023, nr. 5673 dt. 31.05.2023.
6. Shtesë plani e transfertës së pakushtëzuar për investime sipas VKB nr. 18, dt. 06.09.2023 në shumën 1,038 mijë lekë, me shkresë nr. 63381/1 dt.27.04.2023.
7. Shtesë plani e transfertës së pakushtëzuar për investime sipas VKB nr. 31, dt. 31.10.2023 në shumën 2,167 mijë lekë me shkresë nr. 12674 dt.10.07.2023.
8. Shtesë plani e transfertës së pakushtëzuar për likuidim të detyrimeve të prapambetura sipas VKB nr. 48, dt. 26.12.2023 në shumën 24,437 mijë lekë, me shkresë nr. 22656/6 dt.20.12.2023.
9. Shtesë plani e transfertës së kushtëzuar për likuidim të detyrimeve të prapambetura sipas shkresës nr. 2433, dt. 28.12.2023 në shumën 233,371 mijë lekë.
10. Financim i huaj për investime në shumën 13,106 mijë lekë (rikonstruksion i shkollës “Koço Korçari” dhe rikonstruksion i shkollës “Shaban Plaku...”.
11. Shtesë plani i transfertës së kushtëzuar në shumën 940 mijë lekë për shpërblimin e punonjësve zjarrfikës, fondi 705 mijë lekë për paga e sigurime për Gjendjen Civile, fondi 6,300 mijë lekë për investime (ndërtim banesa sociale) si dhe fondi i ndihmës ekonomike dhe paaftësisë në shumën 212,571 mijë lekë.

Si rezultat i rritjeve buxhetore është rakorduar me Thesarin për planin e shpenzimeve në vlerën **1,204,405 mijë lekë**.

Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar

të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2023 referuar aktrakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2023								
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja në Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordi mit	Te ardh veta	Grand	Trans. pakushtez Spec.	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Per Inv.	Grand i huaj
1	Paga (600)	235,114	256,201	238,726	81,101	53,785	96,811	7,029	0	0
2	Sigurime (601)	39,522	42,560	39,528	11,269	10,985	16,627	647	0	0
3	Shpenzime (602)	158,381	161,303	131,880	58,314	61,049	12,125	392	0	0
4	Shpenzime (604)	5,465	11,196	2,826		659		2,167	0	0
5	(609) F. Rezervë	11,578	4,272	0	0	0	0	0	0	0
6	Inv(230 +231)	118,654	501,164	430,724	33,594	112,257	960		263,708	20,205
7	Transferta 606	11,438	227,709	219,245	6,299	8050	50	204,846	0	0
	Totali	580,152	1,204,405	1,062,930	190,577	246,785	126,573	215,081	263,708	20,205

Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2023, nga 1,204,405 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,062,930 mijë lekë ose në masën 88 %, sipas burimit të financimit e buxheti në fakt është financuar si më poshtë: Nga të ardhurat e veta në masën 18% ose në vlerën 190,577 mijë lekë.

Nga grand i huaj në masën 23% ose në vlerën 246,785 mijë lekë.

Nga transfertat e pakushtëzuar specifike në masën 12% ose në vlerën 126,573 mijë lekë.

Nga transfertat e kushtëzuar funksionet e deleguara 20% ose në vlerën 215,081 mijë lekë.

Nga transfertat e deleguar për investime 25% ose në vlerën 263,708 mijë lekë.

Nga grand i huaj 2% ose në vlerën 20,205 mijë lekë.

Sipas artikujve të shpenzimeve treguesit e buxhetit në tërësi dhe sipas burimeve të financimit janë realizuar si më poshtë:

-Pagat (600) nga 256,201 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 238,726 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura të veta në vlerën 81,101 mijë lekë, grand në vlerën 53,785 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 96,811 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar funksione të deleguara në vlerën 7,029 mijë lekë) ose 93%.

-Sigurime shoq. (601) nga 42,560 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 39,528 mijë lekë, me burim financimi (të ardhurat e veta në vlerën 11,269 mijë lekë, grand në vlerën 10,985 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 16,627 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar funksione të deleguara në vlerën 647 mijë lekë) ose 93%.

-Shpenzime operative (602) nga 161,303 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 131,880 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura e veta në vlerën 58,314 mijë lekë, grand në vlerën 61,049 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 12,125 mijë lekë dhe transfertat e pakushtëzuar funksione të deleguara në vlerën 392 mijë lekë) ose 82%.

-Shpenzime për ndihma nga transfertat dhe fond rezervë (604-609) nga 243,177 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 222,071 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura e veta në vlerën 6,299 mijë lekë, grand në vlerën 9,010 mijë lekë dhe transfertat e pakushtëzuar specifike në vlerën 50 mijë lekë dhe transfertat e pakushtëzuar funksione të deleguara në vlerën 207,013 mijë lekë) ose 91%.

-Shpenzime për investime (230-231) nga 501,164 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 430,724 mijë lekë, me burim financimi (të ardhura e veta në vlerën 33,594 mijë lekë, grand në vlerën 112,257 mijë lekë dhe transfert e pakushtëzuar specifike në vlerën 960 mijë lekë, transfert e pakushtëzuar funksione të deleguara në vlerën 263,708 mijë lekë dhe donatorë të huaj në vlerën 20,205 mijë lekë) ose 86%.

Buxheti i miratuar është realizuar nga Aparati i Bashkisë, Ndërmarrja Komunale, Qendra ekonomike e Arsimit dhe Qendra kulturore të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Emertimi	Bashkia		Nd.Komunale		Q. Ek. Arsimit		Q.Kulturore	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Paga (600)	108,050	96,121	31,292	30,272	110,143	105,903	6,716	6,431
2	Sigurime (601)	17,503	15,473	5,179	5,050	18,756	17,934	1,122	1,071
3	Shpenzime (602)	87,812	66,285	42,990	38,165	26,349	24,058	4,152	3,372
4	Shpenzime (604)	11,196	2,826	0	0	0	0	0	0
5	Transferta 606	214,331	206,024	180	36	13,198	13,183	0	0
6	F. Rezervë 609	4,272	0	0	0	0	0	0	0
7	Inv(230 +231)	493,366	423,246	4,161	4,041	2,838	2,822	800	616
	Totali	936,530	809,975	83,802	77,564	171,284	163,900	12,790	11,490

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se 78% e planit të buxhetit ose në vlerën 936,530 mijë lekë e zë Aparati i Bashkisë, 7% e planit të buxhetit ose në vlerën 83,802 mijë lekë e zë Nd/Komunale, 14% e planit të buxhetit ose në vlerën 171,284 mijë lekë e zë QEA dhe 1% e planit të buxhetit ose në vlerën 12,790 mijë lekë e zë QK.

Referuar situacionit të shpenzimeve për Aparatin e bashkisë rezulton se shpenzimet buxhetore nga 936,530 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 809,975 mijë lekë ose 86%.

-Pagat (600) nga 108,050 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 96,121 mijë lekë ose 89%.

-Sigurime shoq. (601) nga 17,503 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 15,473 mijë lekë ose 88%.

Shpenzime operative (602) rezulton se janë planifikuar për vlerën 87,812 mijë lekë e në fakt janë realizuar 66,285 mijë lekë ose 75%, pra më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi. Mosrealizimi vjen si rezultat i mos likuidimit e shpenzimeve për shpronësimet si rezultat i mungesës së dokumentacionit, shpenzime të dekorit për të cilën nuk është lidhur kontratë dhe shpenzime pastrimi.

Për sa i përket likuidimit të shpenzimeve operative, sipas urdhër shpenzimeve rezulton se me buxhetin e vitit 2023 janë likuiduar fatura për mallra e shërbimi të vitit 2022, në vlerën 1,040,372 lekë dhe shpenzime të vitit në vlerën 65,244,903 lekë, sipas pasqyrës Aneks 2/2 bashkëlidhur.

Shpenzime për investime (230-231) rezulton se janë planifikuar për vlerën 493,366 mijë lekë e në fakt janë realizuar 423,246 mijë lekë, me mosrealizim për vlerën 70,120 mijë lekë (nga fondet e veta në vlerën 22,169 mijë lekë dhe fondet e deleguara në vlerën 46,370 mijë lekë) ose 86%, sipas objekteve sipas pasqyrës Aneks 3/2 bashkëlidhur.

Arsyet e mosrealizimit të investimeve në një rast planifikuar në vlerën 2,000,000 lekë nuk është zhvilluar procedurë prokurimi, në një rast planifikuar në vlerën 4,442,436 lekë nuk është miratuar projekti dhe nuk është përfunduar grand, procedurat e prokurimit janë zhvilluar me vonesë dhe objektet nuk kanë përfunduar etj.

Për sa i përket likuidimit të shpenzimeve për investime, sipas urdhër shpenzimeve rezulton se me buxhetin e vitit 2023 janë likuiduar shpenzime për investime të vitit 2022, në vlerën 181,615,276 lekë dhe investime të vitit në vlerën 230,425,841 lekë, sipas pasqyrës Aneks 4/2 bashkëlidhur.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2023, janë dërguar MFE me shkresat nr. 1796, datë 29.05.2022 “Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë”, nr 3191, datë 25.09.2022 “Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin e vitit 2023” dhe shkresa nr 772, datë 26.02.2023 “Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2023”, brenda afateve ligjore.

-Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totalishpenzimevetëmimiratarapër NJVQV-në	Stoku/Shpenzimevetotaletëmimirataratë NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua sfatgjatë			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kreditëfurnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)			2.51%
a	Shpenzimekorrente	278		
a,1	Mallradheshërbime	278		
a,2	Pagadhesigurime			
a,3	Tëtjera			
b	Shenzimekapitale	16,179		
b,1	Insitucionebuxhetore			
b,2	Subjekte private	16,179		
c	Vendimegjyqësore			
c,1	Marrëdhëniepune			
c,2	Mallradheshërbime			
c,3	Investime			
c,4	Tëtjera			
III	Totali (I+II)	16,457	654,423	2.51

Sa më sipër rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 16,457mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 654,423 mijë lekë zënë 2.51%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 728 prot., datë 22.02.2024.

Të analizuara detyrimet e prapambetura të raportuara në MFE paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Emëri i furnitorit	Fatura		Vlera lekë
		Nr	Datë	
1	A shpk	31	12.06.2023	1,494,348
2	B shpk	25	01.09.2023	6,223,664
3	B shpk	45	06.09.2023	6,404,865
4	D	58	24.10.2023	378,500
5	F	19	22.06.2023	9,000
6	K shpk	133	12.10.2023	1,547,820
7	K			40,000

8	RR shpk	1	18.01.2022	238,800
9	T 07	32	30.06.2015	105,600
10	T shpk			14,820
	Detyrime që financohen me fondet e Bashkisë			16,457,417

Nga të dhënat e bilancit rezulton se detyrimi i faturave të pa likuiduara dhe vendime Gjykate në fund të vitit 2023, që i përkasin llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” janë për vlerën 9,922,981 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” janë për vlerën 27,067,903 lekë, gjithsej në vlerën **36,990,884 lekë** sipas të dhënave të pasqyrës **Aneks 5/2 bashkëlidhur**.

Diferenca e detyrimeve të pasqyruara në bilanc dhe atyre të raportuara në MFE në vlerën 20,533,467 lekë (36,990,884-16,457,417) janë fatura të cilat i përkasin muajit dhjetor e nuk janë likuiduar për shkak se nuk kanë përmbushur afatin 60 ditorë.

Konstatimi: Totali i detyrimeve të pa likuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 16,457 mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 654,423 mijë lekë zënë 2.51%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 728 prot., datë 22.02.2024. Nga auditimi ka rezultuar se nuk janë raportuar si detyrime të vitit 2023 detyrimet për vlerën 15,442,402 lekë që i përkasin subjekteve (“B” shpk për faturën nr. 65, datë 06.11.2023 për vlerën 10,186,960 lekë dhe subjektit “B” shpk për faturë nr. 25, datë 01.09.2023 për vlerën 5,357,442 lekë), të cilave i ka kaluar afati 60 ditorë, këto detyrime janë raportuar në vitin 2024 sipas Urdhër regjistrimit nr. 5 dhe 6, datë 21.03.2024, veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të MFE nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 126.1 Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, germa “a”.

-Dokumentacioni mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes Ministrisë, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Koçovë ka përfitur fonde nga Ministritë në vlerën 310,077,903 lekë nga të cilat janë likuiduar gjatë vitit në vlerën 263,708,445 lekë, për objekte të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Objekte	Plani	Fakti
1	Ndërtim i ujësjellësit për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Vodëz, Sheqëz dhe Koritëz...	231,132,133	231,131,691
2	Ndërtim i ujësj fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Vodëz, Sheqëz dhe Koritëz. Supervizim	2,239,146	2,239,145
3	Ndërtim i ujësj fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Vodëz, Sheqëz dhe Koritëz. Kolaudim	718,708	-
4	Ndërtim banesa sociale, shtese kati II	6,300,559	6,300,559
5	Rikonstruksioni i Shkolles "Llazar Kuli" Perondi	32,204,051	12,125,370
6	Mbrojtja nga grryerja e rruges Lumas, ndëtim ura Sarasel Belesove, Mendrake.	37,483,306	11,911,680
	TOTALI	310,077,903	263,708,445

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhe me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjor mbahet ky akt konstatimi me znj. H.SH me detyrë Drejtore e Financës dhe Buxhetit, për periudhën e auditimit.

Nënpika 2.2.6. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 .

Te ardhurat e programuara në PBA 2023-2025 mbështeten në nivelin e miratuar për taksat dhe tarifat vendore të vitit 2023, për çdo kategori taksapaguesish dhe njësitë administrative: Njësia Administrative Kuçovë, Kozare, Perondi dhe Lumas.

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 34, pika 3 dhe 4, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore” përcakton se bashkitë krijojnë të ardhura nga: a) taksat vendore mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksat vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; c) taksat vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksat vendore mbi të ardhurat vetjake, të krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; d) të ardhura nga donacionet dhe

dhuratat; dh) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; e) taksa të tjera të përcaktuara me ligj.

Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ndryshimet respektive sanksionon kuadrin ligjor bazë për sistemin e taksave dhe tarifave vendore si dhe rregullat bazë në mbledhjen, administrimin dhe në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njëjësive të qeverisjes vendore. Mbështetur në kornizën kryesore të qeverisjes vendore dhe parimet e decentralizimit të njëjësive të qeverisjes vendore, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara në ligjin përkatës.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.

Në PBA 2023-2025 për vitin 2023 gjenerimi të ardhurave mbështet në tarifave vendore të miratuara nga KB për vitin 2023. Sipas paketës fiskale për të ardhurat vendore, ato janë kategorizuar në dy grupe:

1. **Të ardhura tatimore nga taksa dhe tarifa vendore** si taksa vendore mbi pasuritë e luajtshme e te paluajtshme dhe transaksionet mbi to si: taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël e të madh; taksa vendore mbi veprimtaritë e shërbimeve hoteliere; taksa vendore të përkohshme e të tjera të përcaktuara me ligj dhe të ardhura jo tatimore;

2. **Të ardhura jo tatimore** të përbëra nga të ardhurat nga tarifave për shërbimet e ndryshme, - të ardhurat nga shitja dhe dhënia me qira, të ardhura të tjera.

Këshillit Bashkiak me VKB nr. 79, datë 22.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr. 73, datë 30.11.2022, “Për Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 956/2 prot, datë 09.11.2023, ka miratuar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023.

Përgjatë vitit 2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar, zbatuar dhe realizuar 1 paketë fiskale.

Këshillit Bashkiak me Vendim të nr.81, datë 22.12.2022 “Për kategorizimin e nivelit të pagave të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar, si dhe punonjësve të administratës së Bashkisë dhe njëjësive të saj në varësi për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Berat me shkresë nr.956/2prot, datë 01.01.2023 “Për verifikimin e akteve” **ka miratuar strukturën organike**, kategoritë/klasat e pagave të administratës së Bashkisë dhe njëjësive shpenzuese të saj,

Kryetari Bashkisë me Vendim nr.1, datë 12.01.2023 “Miratimi strukturës së administratës së bashkisë dhe të njëjësive shpenzuese në varësi të bashkisë Kuçovë për vitin 2023”, ka miratuar **strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve**, të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë.

Drejtoria e të Ardhurave për taksat e tarifave vendore, pjesë e strukturës së Bashkisë Kuçovë, e përmbush detyrën e saj në mbështetje të ligjeve dhe të gjitha akteve normative që lidhen me taksat dhe tarifave vendore, me gjithë ndryshimet që ato pësojnë në vijimësi. Drejtoria e të Ardhurave ka funksionuar, me **12 nëpunës** gjithsej, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 2(dy) Përgjegjës Sektori dhe 3 Specialistë, 4(katër) agjent tatimor, 1(një) punonjës tatimor dhe 1(një) administrator i tregut të përqendruar.

Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtoritë e Bashkisë planifikojnë dhe gjenerojnë të ardhura, në bashkëpunim me Agjentët Fiskalë, duke organizuar punën për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave vendore për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Bazuar në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e Taksave Vendore “ i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore sektoriale, Bashkia Kuçovë dhe NJA të saj, **në PBA 2023**, për taksat dhe të gjenerojë të ardhura për rreth **13,674 subjekte** mbi të cilat aplikohen taksat dhe tarifave vendore, të ndara në 4 kategori: **1.Biznes; 2.Ambulant; 3.Familjar; 4.Institucione.**

Numri dhe kategoria e taksapaguesve 2023 taksat dhe tarifave vendore, si dhe numri i tyre.

Nr.	Lloji	2022	2023
1	Biznesi i Madh	105	111
2	Biznesi i Vogël	621	646

3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	170	170
4	Ndërmarrje/Institucione	27	27
5	Familje	12,286	12,720
	Total	13,209	13,674

(Burimi: DAV Bashkia Kuçovë)

Kategoritë e mësipërme me përjashtim të institucioneve, ndahen **në nënkategori** për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:-Kategoria e Biznes ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël. Kategoria “*Familjarë*” për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Në PBA 2023-2025 programi i të ardhurave për vitin 2023 në total u programua **225,188 mijë** lekë, të ardhura që do të gjenerohen nga **13,674** subjekte taksapagues, të grupuar sipas llojit të taksave dhe tarifave dhe llojit të biznesit si më poshtë vijon.

Plani i të ardhurave për PBA 2023-2025 *(në mijë leke)*

	Te Ardhura tatimore	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2022	Plani 2023
I.	Te ardhura nga taksat	43,057	80,685	75,089	74,123
II	Te ardhura nga tarifatat	55,106	103,901	112,205	121,532
III.	Te ardhura nga dhënia me qira	2,387	2,499	4,128	3,850
IV	Te ardhura të tjera	15,197	17,881	17,553	25,683
	Totali të ardhurave të veta	115,747	204,966	208,975	225,188

(Burimi: Bashkia Kuçovë, PBA 2023-2025)

Referuar planifikimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, konstatohet se për vitin 2023 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **225,188 mijë** lekë me parashikim në rritje për rreth 16,213 mijë lekë ose 7% më shumë nga plani 2022.

Peshën më të madhe të të ardhurave vendore e zë Bashkia Kuçovë 182.267mijë lekë ose 80,94% të totalit të të ardhurave, e ndjekur nga Nj.Ad. Perondi me 20.312 mijë lekë ose 9,02%, Nj.Ad. Kozarë me 14.773 mijë lekë ose 6,56% dhe Nj.Ad. Limas me 7.836 mijë lekë ose 3,48%.

PBA 2023 sipas njësive administrative *(në mijë lekë)*

Njësia Administrative	Vlera (në mijë leke)	Pesha specifike ndaj totalit
Kuçovë	182.267	80,94%
Kozarë	14.773	6,56%
Perondi	20.312	9,02%
Lumas	7.836	3,48%
TOTALI	225.188	100,00%

(Burimi: Bashkia Kuçovë, PBA 2023-2025)

Realizimi i të ardhurave për vitin 2023 është në shumën **210,068 mijë lekë** duke rezultuar me mos realizim **15,120 mijë lekë** ose realizuar në masën **93.29%** krahasuar me planifikim në PBA 2022-2023 në të cilin janë planifikuar 225,188 mijë lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifatat vendore 2023 *(në mijë leke)*

Nr.	EMERTIMI	Fakt progresiv 2023	Buxhetit vjetor 2023	Fakt/Plan	Realizuar (%)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	210,068	225,188	-15,120	93.29%
1	Taksat e veta vendore	38,375	46,839	-8,463	81.93%
a.	Taksa mbi pasurinë	8,073	7,947	126	101.58%
b.	Biznesi i vogël	149	500	-351	29.78%
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3,199	5,000	-1,801	63.98%
d.	Taksa të tjera vendore	26,955	33,392	-6,437	80.72%
2	Të ardhura jo tatimore	139,350	152,349	-13,000	91.47%
a.	Tarifatat e shërbimeve publike	58,982	69,390	-10,408	85.00%
b.	Tarifata administrative	1,998	4,240	-2,242	47.13%
c.	Të tjera jo tatimore	78,370	78,719	-350	99.56%
3	Taksa të ndara	32,343	26,000	6,343	124.40%

a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pas. e paluaj	-	-	-	-
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	16,858	16,000	858	105.36%
c.	Renta minerare	2,165	3,000	-835	72.18%
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	13,320	5,000	8,320	266.40%
e.	Të tjera	0	2,000	-2,000	0.00%

(Burimi: DAV, bashkia Kuçovë)

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Kuçovë për vitin 2023 u realizua në masën 93.29% (pa përfshirë zërin sponsorizime dhe grande) nga 225,188 mijë lekë të parashikuara u realizua në vlerën 210,068 mijë lekë me mosrealizim prej 15,120 mijë lekë.

Taksat vendore rezultuan me mos realizim për 8,463 mijë lekë ose realizuar në masën 81.93%. Të ardhurat jo tatimore rezultuan me mos realizim për 13,000 mijë lekë ose realizuar në masën 91.47%. Taksa “Të tjera” rezultuan me realizim për 6,343 mijë lekë ose realizuar në masën 124.40% Por pavarësisht realizimit, në këtë grup taksash rezultoi se taksa e rentës minerare rezultoi me mos realizim për 835 mijë lekë ose realizuar në masën 72.18%

Nga taksat dhe tarifave e mësipërme sipas peshës specifike për vitin 2023 të ardhurat vendore më pak të realizuara rezultuan: -Tarifë pastrimi realizuar 35,965 mijë lekë ose realizuar në masën 85.73%; tatim toke realizuar 7,049 mijë lekë ose realizuar në masën 53.99%;tarife vendore ndriçimi realizuar 9,230 mijë lekë ose realizuar në masën 79.57%; tarifë gjelbërimi realizuar 10,183 mijë lekë ose realizuar në masën 90.92%; tarifë zënie e hapësi publike realizuar 8,533 mijë lekë ose realizuar në masën 77.55%; taksë për ndërtime të reja urbane realizuar 3,199 mijë lekë ose realizuar në masën 63.98%; tarife për infrastrukture arsimore realizuar 3,573 mijë lekë ose realizuar në masën 77.08%; renta minerare realizuar 2,165 mijë lekë ose realizuar në masën 72.18%; qira për toke bujqësore realizuar 2,085 mijë lekë ose realizuar në masën 83.41%.

Konstatim: Për vitin 2023 niveli i realizimit të të ardhurave në Bashkinë Kuçovë rezultoi në masën 93.29% (pa përfshirë zërin sponsorizime dhe grande) ose me mosrealizim prej 15,120 mijë lekë, duke sjellë diferencë ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta. Mos realizimi të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë. Këto veprime janë kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kuçovë miratuar me VKB nr. 79, date 22.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne VKB nr. 73, datë 30.11.2022, “Për Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2023.

Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoritë e tjera të Bashkisë Kuçovë, Agjentet Fiskale të kontraktuar për arkëtimin e të ardhurave vendore, në funksion të realizimit të programit të të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2023, sipas tarifave të miratuara me VKB nr. 73, datë 30.11.2022 “Mbi miratimin e tarifave dhe Taksave Vendore për vitin 2023 ” ka gjeneruar të ardhura në shumën 210,068 mijë lekë².

Vlerësimi i të ardhurave si më poshtë vijon:

-Tarifat e Pastrimit:

Te ardhurat nga pastrimi burojnë nga të tarifave që aplikohen pastrimin dhe per largimin e mbeturinave. Faturimi për arkëtimin e tarifës për Njësinë Administrative Kuçovë për “Abonentë familjarë” realizohet nga Agjenti Tatimor, ne bazë të Akt Marrëveshjes së lidhur me Ujësjellës Kanalizime. Për Njësinë Administrative Perondi, Kozarë dhe Lumas faturimet dhe arkëtimet për

² Aneksi nr.2.6.2.1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Kuçovë, viti 2023 (në 000 lekë)

“Abonentë familjarë” realizohet nga vetë njësitë administratave. Per Institucionet, subjektet e biznesit të madh e dhe subjektet e biznesit të vogël, që janë ne territorin e bashkisë Kuçovë, faturimi dhe arkëtimi behet nga Drejtoria e Vendore ne Bashkinë Kuçovë.

Drejtoria e të Ardhurave ka mbajtur akt rakordime mujore me Agjenti Tatimor, ne bazë të Akt Marrëveshjes së lidhur me Ujësjiellës Kanalizime dhe Degën e Thesarit për të ardhurat nga tarifa e pastrimit.

Të ardhurat nga tarifa e pastrimit u planifikuan 41,954 mijë lekë dhe u realizuan 35,965 mijë lekë, duke rezultuar me mosrealizim për 9,989 mijë lekë ose realizuar 85.73 %.

-Tarife Vendore per Ndotje:

Me VKB Nr. 73 datë. 30.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”. Këshilli Bashkiak ka miratuar tarifa vendore për ndotje per subjekte jashte bashkisë, fitues ne tendera e investime te medha, me vlere kontrate deri ne 5 milion leke detyrimi 30.000 leke/tender dhe mbi 5 milion leke detyrimi do te jete 50.000 leke/tender, mbi 10 milion tarifa do te jete 100.000 leke.

Struktura pergjegjese per vjeljen e kesaj tarife eshte Drejt.Zhvillimit Territorit.

Të ardhurat nga tarife vendore për ndotje u planifikuan 36,000 mijë lekë dhe u realizuan 36,100 mijë lekë, duke rezultuar me tejkalim për 100 mijë lekë ose realizuar 100.28%.

-Taksa mbi truallin,

Taksa e truallit aplikohet sipas kërkesave të ligjit nr. 9632 date 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 date 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006, “Për Taksat Vendore”. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme “Truall”i nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme, si nje siperfaqe toke jobujqesore, pavarësisht shfrytëzimit të tyre. Përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave në bashkinë Kuçovë.

Ne zbatim te Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 te ndryshuar, taksa mbi truallin (jo hapësire publike), për vitin 2023 është planifikuar e ardhur ne vlerën 19,690 mijë leke, e strukturuar sipas kategorive: ndërmarrjet, bizneset, dhe familjaret si me poshtë vijon:

Taksa e truallit, paguhet ne buxhetin e bashkisë, ne territorin e se cilës ndodhet prona, sipas afateve: Për abonentët familjar afati deri 30.09.2023; për subjekte e biznesit, ndërmarrje dhe institucione deri më 30.06.2023 dhe për subjektin A taksa e truallit planifikuar dhe realizuar ne vlerën 19,000 mijë leke në vit ose 97.21% te totalit të të ardhurave nga taksa e truallit.

Te ardhurat për vitin 2023 nga taksa e truallit u parashikuan 19,690 mijë lekë dhe arkëtimi u realizua në shumën 19,454 mijë lekë, me mos realizim për 236 mijë lekë ose realizuar 98.80% Arkëtimi me i ulët rezultoi në njësitë administrative Kozarë, Perondi dhe Lumas në të cilat arkëtimi rezultoi 295 mije lekë ose mos realizim 92 mijë lekë ose realizuar 76.26%.

Sipas subjekte tatimpagues: Familjaret rezultuan me realizmin 63%; biznesi i madh me realizim 68% dhe biznesi vogël me realizim 79%

-Taksa e regjistrimit te mjeteve te përdorura:

Kjo takse, ne zbatim te Ligjit nr.9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, arkëtohet nga strukturat e **DPSHTRR Berat** dhe te ardhurat nga kjo takse derdhen ne favor te Bashkisë nga ku Bashkia përfiton 25 % te shumes se arkëtuar.

Te ardhurat e programuara nga kjo takse për vitin 2023,bazuar ne ecurinë e arkëtimit te kësaj takse ne vitin 2023 u parashikuan ne masën 16,000 mije leke dhe u realizuar 16,858 mije leke, me tejkalim të lehtë për 858 mije leke ose realizim 105.36%.

-Taksa mbi token bujqësore:

Te ardhurat nga kjo takse mbi pasurinë për vitin 2023 do te arkëtohet nga tre njësite vendore ne te cilat shtrihet sipërfaqja e tokës bujqësore e ndare me ligjin nr. 7501 , dt.19/07/1991 ne baze te regjistrave te krijuar duke u bazuar ne sipërfaqen e tokës bujqësore për çdo tatimpagues si dhe

ne vlerën për çdo kategori të shprehur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar.

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore llogaritet si prodhim i sipërfaqes me çmimin sipas kategorisë. Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore është bërë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky detyrim është vjetor dhe paguhet me një këst të vetëm deri më 30 shtator 2023.

Strukturat e ngarkuara për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore janë Njësitet Administrative: Administratori i njësive, inspektori i të ardhurave dhe specialisti i bujqësisë pranë njësive si dhe në bashkëpunim me kryeplakun e fshatit.

Sipërfaqja e tokës e ndare me ligjin nr. 7501 datë 19/07/1991 në të tre Njësitet Administrative mbi të cilën llogaritet të ardhurat është 6,096 Ha, e detajuar sipas Njësive është si më poshtë.

Të ardhurat për vitin 2023 u parashikuan 13,056 mijë lekë dhe arkëtimi u realizua në shumën 7,049 mijë lekë, duke rezultuar me mos arkëtim për 6,007 mijë lekë ose realizuar 53.99%.

-Tarife Vendore Ndriçimi:

Në VKB nr. 73, datë 30.11.2022 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023" u parashikuan të ardhura 11,600 mijë lekë nga tarifa vendore e ndriçimit.

Për "Abonentët Familjarë" në Njësitet Administrative Kuçovë, tarifa e ndriçimit përfshihet në faturën mujore të lëshuar nga agjenti Ujësjetësi Kanalizime.

Për "Abonentët Familjarë" në Njësitet Administrative Perondi dhe Kozarë faturimi bëhet me një këst të vetëm dhe njësitet administrative kryejnë arkëtimin e saj.

Të ardhurat për vitin 2023 u realizuan në shumën 9,230 mijë lekë, duke rezultuar me mos realizim për 2,370 mijë lekë ose realizuar 79.57%.

Sipas llojeve të subjekteve arkëtimet më të ulëta rezultojnë në kategorinë "Biznes i vogël" për mosrealizim për 1,080 mijë lekë ose realizim 61.41% dhe arkëtime nga popullata për 921 mijë lekë ose realizim për 85.54%.

-Tarifë Gjelbërimi:

Bazuar VKB 73/2022 paketën fiskale për vitin 2023 për përmirësimin e mjedisit dhe shtimin e hapësirave të gjelbër tarifa e shërbim gjelbërimit dhe mjedisit, për vitin 2023, nivelet e kësaj tarife, kanë pësuar ndryshime në rritje për kategorinë familje, biznes dhe ndërmarrje ku rritja të ndjeshme konstatohet në kategorinë "N" kryesisht për subjektet "A" sha për të cilën rritja është 1.000.000 leke dhe "SH" (komp.Hidrokarbure) për të cilën tarifa rritet me 200.000 lekë, për të cilat afati i pagesës është deri në qershor të vitit 2023.

Agjenti Tatimor: Për abonentët familjare në njësitet administrative Kuçovë, Perondi e Kozarë, është U SHA, Rajoni Berat, i cili përfiton komision 2.5 % të vlerës së arkëtuar; për abonentët familjarë që nuk janë të përfshirë në kontratë me Ujësjetësin, Agjenti Tatimor janë vetë Njësitet Administrative. Për taksapaguesve familjarë pa kontratë me ujësjetësin Drejtoria e të Ardhurave ngarkohet me faturimin dhe vjeljen e detyrimeve, për subjekte të biznesit si dhe N dhe institucione,

Për vitin 2023 tarifa e gjelbërimit u realizua 10,183 mijë leke kundrejt parashikimit 11,200 mijë leke në PBA 2023, duke rezultuar me mos realizim për 1,017 mijë lekë ose realizuar 90.92%.

Ndikim të ndjeshëm në grupin "N dhe institucione" kanë subjektet "A" sha më arkëtim 400 mijë lekë dhe "SH" me arkëtim 1,700 mijë lekë. Me mosrealizim u paraqiten të katër grupet subjekteve të tarifuar, veçanërisht mosrealizim më i lartë paraqitet në kategorinë "Biznes i madh", për më pak të ardhura nga tarifa e gjelbërimit në shumën 283 mijë leke ose realizuar 60.08%, si më poshtë:

-Tarifë Zënie e Hapësi Publike:

Në zbatim të ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", neni 32, është e përcaktuar në masën 60 leke/m²/muaj për vitin 2022, me të drejtën e korrektimit të këtij niveli për njësitet administrative periferike. Pagesës së kësaj tarife i nënshtrohen të gjitha subjektet që

administrojnë hapësire publike për interesat e biznesit të tyre në të gjithë shtrirjen territoriale të bashkisë Kuçovë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen, arkëtimin e kësaj tarife është Drejtoria e të Ardhurave, si dhe Njësitë Administrative respektive, për hapësirat që përdoren nga subjektet individ, fizik apo juridik, në këto njësi.

Takse për zënie të Hapësirës Publike

Takse për zënie të Hapësirës Publike	Njësia matëse	Kucova		Kozare		Perondi		Lumas	
		2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
			V1		V1		V1		V1
Hapësira Publike	Leke/m ² /muaj	60	70	30	35	30	35	30	35
Ndikimi	Leke/m ² /muaj		+10		+5		+5		+5

(Burimi: VKB 73/2022 Bashkia Kuçovë)

Bazuar në kontratat e lidhura me subjektet e biznesit të madh, të biznesit të vogël për shfrytëzimin e hapësirës publike, me ambulantet në tregun e përqendruar si dhe të ardhurat që vijnë nga tregu i lirë, sipas strukturës së subjekteve, takse për zënie të hapësirës publike u planifikua 11,004 mijë lekë dhe u realizua 8,533 mijë lekë, duke rezultuar me mosrealizimin për 2,471 mijë lekë ose realizuar 77.55%, megjithëse në paketën fiskale 2023 ka rritje të kësaj takse nga 5 deri 10 lekë/m²/muaj.

-Taksa mbi ndërtesat:

Në zbatim të ligjit nr. 106/2017 datë 30.11.2017 "për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006,"Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, V.K.M nr. 132 datë 07.03.2018 "për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", Këshilli i Bashkisë me Vendimin nr.66 datë 22.08.2018, ka përcaktuar nivelin dhe shkallën e çmimit të referencës për çdo njësi administrative dhe për kategoritë e pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa".

Këshilli Bashkiak me VKB 73/2022 ka miratuar nivelet e taksës mbi ndërtesat sipas kategorive dhe nënkategorive për katër njësitë administrative.

Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për kategorinë, I. "Ndërtesa Banimi", si dhe kategorinë II. "Ndërtesa të Tjera", është Ujësijellësi U , shoqëri me shtrirje territoriale në gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë, vlera të cilës duhet të jetë mujore dhe përfshihet në faturën mujore të lëshuar nga U SHA.

Planifikimi i të ardhurave nga taksa mbi ndërtesën bazohet në sipërfaqen faktike të ndërtesës në m² me tarifën të miratuar në VKB nr. 73, datë 30.11.2022 si dhe VKB nr. 74 datë 24.11.2021: - Për çdo ndërtesë banimi për familjarët; për çdo ndërtesë në të cilën ushtrohet aktivitet tregtar apo shërbimi nga biznesi i madh dhe biznesi i vogël.

Mbështetur dhe në arkëtimet e viteve si dhe në bazën e regjistrave të krijuar për taksën e ndërtesës në bashki dhe njësitë administrative të ardhurat u realizuan **8,073 mijë lekë** duke rezultuar me tejkalim 126 mijë lekë ose realizuar 101.58% krahasuar me planifikim 2023 për vlerën 7,947 mijë lekë.

Për tarifën për privatizim banesë nuk ka patur realizim të ardhurash.

-Taksë për Ndërtim të Reja Urbane:

Në zbatim të ligjit 9632 datë 30.10.2006,"Për Taksat Vendore" nëni 27 pika 2, si dhe ligjit nr. 142/2015 datë 17.12.2015, "për disa ndryshime në ligjin "për Taksat Vendore" nëni 14, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukture, përcaktohet sipas natyrës së investimit dhe në vitin 2023 sipas VKB 73/2022 Bashkia Kuçovë ka ruajtur të njëjtat nivele si në vitin 2022. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukture përbehen nga lejet për ndërtimet e reja dhe legalizimet.

Mbështetur në realizimin e viteve paraardhëse, ndërtimeve dhe bashkëpunimit me ASHK Kuçovë për kërkesave për legalizim, Bashkia ka planifikuar rreth 5,000 mijë leke të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukture për ndërtimet e reja dhe rreth 2,000 mijë leke nga legalizimi i ndërtimeve informale në bazë të zbatimit të procedurave të legalizimit.

Struktura e ngarkuar per vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për kategoritë : a- Per projekte të Infrastruk; b- Ndertime të tjera(biznes); c- Shtëpi banimi; e- Ndërtime për qëllime bujqësi, blegtori; “d” për ndertime në proces legal; f-Ndertime funksion prodh industr,mater porositesi është Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Kuçovë. Realizimi të ardhurve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja u realizua rreth 3,199 mijë lekë ose 1,801 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor ose realizuar 63.98%.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë (në mijë lekë)

Lloji i taksës, tarifës	Plani ‘23	Fakti ‘23	Ndryshimi	Realizimi (%)
Taksë për Ndërtime të Reja Urban	5,000	3,199	(1,801)	63.98%
Tarifë e ndikimit në Infrastrukturën e legalizimit	2,000	-	(2,000)	0.00%

(Burimi: DAV bashkia Kuçovë)

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe e Koordinimit Zhvillimit Strategjik e cila planifikon dhe llogarit taksën e ndikimit në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje, konstatohet se nga ASHK Kuçovë janë dërguar për vitin 2023, zyrtarisht me shkresë nr. 230, datë 16.02.2023, nr. 2296, datë 26.05.2023, nr. 3186, datë 25.07.2023, nr. 1464, datë 28.12.2023, të protokolluara në bashki lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Kuçovë. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, ka rezultuar se sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas listës progresive 874 persona me vlerë 23,447,723 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Drejtoria e të Ardhurave Lokale nuk ka zbatuar kriteret ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c.

Konstatim: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponohen për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se nga ASHK Kuçovë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Kuçovë. Për periudhën deri më 31.12.2023, sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezultoi se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 874 persona me vlerë 23,447,723 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Nga auditimi rezultoi se nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit bashkia Kuçovë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27-Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3/c. Gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2023 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 23,447,723 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

z. F.P , ish- Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit .

z. S.L , Drejtor i Drejtorisë së Ardhurave Lokale.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.945/12 prot, datë 22.04.2024 [lidhur AK nr.3; AK nr.5 dhe AV nr.1], protokolluar në KLSH me nr. 360/2 prot, datë 22.04.2024 prot, datë, nga Z.S.V në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimi dhe Zhvillimit të Territorit, Koordimimi- Zhvillimit Strategjik, dhe shkresë nr.945/13 prot, datë 19.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 360/3 prot, datë 22.04.2024 prot, datë, nga Z.S.L, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

*Lidhur me “**Taksën për ndërtim të reja**” (pika10/AK), lidhur më pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimet, DPZHT sqaron se janë marrë masat për njoftimin e qytetarëve për shlyerje detyrimi sipas listës së dërguar nga ASHK (shkresa nr. 3570 prot, datë 23.10.2023; shkresa nr. 1265 prot, datë 04.04.2024;shkresa nr.1400 prot, datë 16.04.2024).*

Gjithashtu për personat që nuk kanë kryer pagesat brenda afatit të përcaktuar në shkresa, është kryer njoftimi i Drejtorisë së të Ardhurave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për arkëtim (shkresa nr. 1424 prot, datë 17.04.2024) [bashkëlidhur shkresat e sipërcituara].

Drejtoria e të Ardhurave është në pritje të listës totale debitore nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për të filluar procedurën e masave shtrënguese;

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur përsëri observacioni me shkresë nr.945/17 prot, datë 29.05.2024 protokolluar në KLSH me nr. 360/6 prot, datë 31.05.2024 prot, nga Bashkia Kuçovë, ku janë shprehur objeksionet e përsëritura të ardhura në fazën e aktkonstatimeve, të cilat kanë ardhur me vonesë dhe nga grupi i auditimit janë reflektuar në fazën e Raportit Përfundimtar të Auditimit të pasqyruara sa më sipër, për të cilën komenti nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, për mos shlyerjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, sqarojmë se pavarësisht marrjes së marrjes së menjëhershme të masave të “Njoftimit për shlyerje detyrimi” sipas shkresave të sipërcituara dhe bashkëlidhur observacionit, deri në këtë fazë auditimi nuk është realizuar pagesa e detyrimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632/2006 “për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, pika 3/c; ligjit 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 23; VKM nr. 860/2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

-Tatim nga te Ardhurat Personale:

Te ardhurat nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale është detyrim ligjor që buron nga ligji nr.9975 date 28.07.2008 “për Taksat Kombëtare ne R.Sh.”, i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 date 27.04.2017 “për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 25 pika 1 dhe pika 2.ç. Njësitë e qeverisjes vendore, përfitojnë 2 % të të ardhurave nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale. Agjenti Fiskal i mbledhjes së kësaj takse kombëtare është Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.

Struktura përgjegjëse për rakordimin me agjentin fiskale dhe ndjekjen e realizimit te detyrimeve deri ne prezantimin e tyre ne buxhetin e bashkisë është Drejtoria e te Ardhurave në bashkinë Kuçovë.

Realizimi të ardhurve nga Tatim nga te Ardhurat Personale u realizua rreth 13,320 mijë lekë ose 8,320 mijë lekë më shumë se parashikimi buxhetor ose realizuar 266.40%.

-Tarife për Infrastruktura Arsimore

Kësaj tarife vendore, i nënshtrohen të gjitha subjektet fizike dhe juridike dhe subjekte qe ushtrojnë aktivitetet në territorin e bashkisë Kuçove.

Realizimi të ardhurve nga Tarife për Infrastruktura Arsimore u realizua rreth 3,573 mijë lekë ose 1,063 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 4,636 mijë lekë ose realizuar 77.08%. Ky mosrealizim ndihet për gjithë grupet e taksura si subjektet fizike dhe juridike dhe popullatë. Agjenti tatimor U ShA nëpërmjet përfshirjes së të taksës ne faturën e ujit, nuk ka arritur të

arkëtoje të ardhurat e parashikuara ne PBA 2023, duke rriskuar realizmin e te ardhurat do të përdoren për mirëmbajtjen e përmirësimin e infrastrukturës së objekteve arsimore në Bashkinë Kuçovë. Ato mund të shpenzohen vetëm për qëllimet e përcaktuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për vitin 2023 miratuar me VKB Nr.73 datë. 30.11.2022 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023”.

-Tarifat e frekuentimit te Kopshteve dhe Çerdheve

Kjo tarifë shërben për mbulimin e shpenzimeve që bëhen për frekuentimin e fëmijëve dhe menaxhimin e aktivitetit të kopshteve e çerdheve në bashkinë Kuçovë. Për vitin 2023, tarifash e kuotës e vendosur me VKB nr. 73/2022 për frekuentimin e kopshtit ishte 130 leke/dite dhe për çerdheve 120 leke/dite. Struktura përgjegjëse e ngarkuar për arkëtimin e tyre është Qendra Ekonomike e Arsimit.

Realizimi të ardhurve nga Tarifat e frekuentimit te Kopshteve dhe Çerdheve u realizua rreth 4,449 mijë lekë ose 531 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 4,980 mijë lekë ose realizuar 89.34%.

-Renta Minerare

Ne mbështetje të ligjit nr.9975, dt. 28.07.2008 “Per Taksat Kombetare” i ndryshuar, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.26 date 04.09.2008, “Per Taksat Kombetare në R.Sh.” i ndryshuar, paragrafi 2.5, të Ligjit nr.68/2017, date 27.04.2017, “Per Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 25, pika 1 dhe pika 2.c ,njësitet e qeverisjes vendore në të cilat ushtrohet aktiviteti i shfrytëzimit të tokës dhe nentokës për nxjerrjen e hidrokarbureve apo dhe mineraleve, përfitojnë nga ndarja e Rentes Minerare në masën 5 %.

Agjentët Fiskalë për faturimin, arkëtimin dhe transferimin e pjesës takuese 5% që i takon bashkisë Kuçovë, janë Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, si dhe Deget e Doganave.

Struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe realizimin e kësaj të ardhure, nga ndarja e takses kombetare, është Drejtoria e të Ardhurave.

Bazuar në Udhëzimin nr.26 date 04.09.2008 të Ministrisë së Financave, “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, Drejtoria e të Ardhurave, çdo fund muaji, rakordon me Degën e Thesarit duke firmosur akt akordimin.

Realizimi të ardhurve nga taksa kombëtare e rentës minerare u realizua rreth 2,165 mijë lekë ose 835 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor prej 3,000 mijë lekë ose realizuar 72.18%.

-Qiratë e Tokës Bujqësore / Pyjore

Te ardhurat nga qiratë e tokave bujqësore, janë detyrime që burojnë nga shfrytëzimi i tokave bujqësore të cilat janë kontraktuar për dhënie me qira, konform ligjit nr. 8312 date 26.03.1998 “për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar; VKM nr.531 date 21.08.1998, “për tokat bujqësore të pandara”; Udhëzimi nr. 1 date 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”. Çmimi minimal i qirasë për tokat bujqësore është 6,500lek/ha/vit., sipas përcaktimeve të pikës 10, të Udhëzimit nr. 1 date 18.07.2012 “për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

Për qiratë e tokave pyjore tarifata janë të përcaktuara sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për tarifata në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1064, date 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

Struktura/at përgjegjëse për ndjekjen dhe realizimin e tokës bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave dhe realizimin e tokës pyjore është Drejtoria e Zhvillimit Rural.

Në vitin buxhetor 2023, Bashkia Kuçovë nga qiraja e tokës bujqësore planifikoi të ardhura gjithsej 2,500 mijë lekë, të cilat i realizoi 2,637 mijë lekë, duke rezultuar me mosrealizim për 1,213 mijë lekë ose realizuar 68.49%.

Realizimi të ardhurve nga qira për toke bujqësore u realizua rreth 2,085 mijë lekë ose 415 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 2,500 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 83.41%.

Realizimi të ardhurve nga qira për toke pyjore u realizua rreth 552 mijë lekë ose 798 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 1,350 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 40.86%, ose në nivele tejet të ulëta.

Qira per toke bujqësore dhe pyjore (në mijë lekë)

Lloji i taksës, tarifës	Plani '23	Fakti '23	Ndryshimi	Realizimi në %
Qira për toke bujqësore	2,500	2,085	(415)	83.41%
Qira për tokave pyjore	1,350	552	(798)	40.86%
Totali	3,850	2,637	(1,213)	68.49%

(Burimi : DAV Bashkia Kuçovë)

Auditimi mbi likuidimin e detyrimeve nga dhënia me qira e toka bujqësore, për periudhën viti 2023.

Nga Drejtoria e të Ardhurave Lokale për periudhën objekt auditimi administrohen 434 kontrata qiraje për dhënie me qira toka bujqësore të pandara **për sipërfaqe 388 ha** në vlerën **2,591,931 lekë**, me afate 99 vjeçare, të lidhura gjatë viteve 2012- 2013 nga Nj/Administrative Perondi dhe Lumas.

Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të tokave bujqësore të pandara, për kontratat e vitit 2023 dhe më përpara, u konstatua se 93 fermer nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 13,586,066 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve, nuk është dërguar informacion Drejtorisë Juridike me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratave me subjektet sipas pasqyrës si më sipër, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

Konstatim: Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore të pandara për kontratat e vitit 2023 e para, u konstatua **se 93 fermer** nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, **në vlerën 13,586,066 lekë**, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë. Nga Drejtoria e të Ardhurave Lokale, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve, nuk është dërguar informacion Drejtorisë Juridike me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratave me subjektet, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g” dhe VKB Nr. 73 datë. 30.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, pika 16, VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar; Lidhja 2, tabela 2, Ligji nr.8318, datë 01.04.1998 “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar, neni 3 dhe neni 4, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Kreu XI, nenin 89, Pika 2. Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5, Udhëzimin nr. 17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”, Kreu III,

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi:

z. S.L , Drejtor i Drejtoria e te Ardhurave Lokale.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.945/13 prot, datë 19.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 360/3 prot, datë 22.04.2024 prot, datë, nga Z.S.L , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Lidhur me “Taksën e tokës bujqësore”, ju bëjmë me dije se nga Drejtoria e të Ardhurave me shkresën nr.1454 prot, datë 19.04.2024 i ka dërguar Drejtorisë Juridike listën e debitorëve [dokument bashkëlidhur].;

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se lidhur me “Qiratë e tokës bujqësore nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira të tokave bujqësore të pandara, për kontratat e vitit 2023 dhe më përpara, rezultoi se 93 fermer nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 13,586,066 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

Dërgimi i shkresës nr.1454 prot, datë 19.04.2024 për Drejtorinë Juridike me listën e debitorëve, nuk është dokumentacion dhe argument i mjaftueshëm, pasi detyrimi tatimor për subjekte fermerë rezultoi i papaguar, arsye për të cilën komenti nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

-Te ardhura nga Shitja mallra & shërbime

Në këtë kategori përshihen të ardhura nga **tarifa e lëshimit të licencave** për subjektet që **tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë**, të Bashkisë Kuçovë.

Aplikimi i tarifës për lëshimin e licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë bazohen në kërkesat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017; VKM nr.212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”; VKB Nr. 73 datë. 30.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

Struktura e ngarkuar për dhënie e kesaj licence dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e Shërbimit Publik & Transportit. Struktura e ngarkuar për penalitetet dhe për masat shtrenguese për detyrimin e pajisjes me licence dhe pageses me force është Policia Bashkiake.

Realizimi të ardhurave nga shitja mallra dhe shërbimeve u realizua rreth 1,000 mijë lekë ose 1,500 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 2,500 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 40.00%

Drejtoria e Transportit në Bashkinë Kuçovë, jep autorizimet për tregtimin e karburantit me pakicë/të njëjësive të shitjes së lëndëve djegëse, paraqiti listën e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë.

Sipas të dhënave të paraqitura Drejtoria e Transportit në Bashkinë Kuçovë, për vitin 2023 kanë ushtruar aktivitet 15 subjekte pasqyruar si më poshtë vijon:

Subjektet tregtim karburanti me pakicë 2023

Nr.	Karburanti	Autorizim		Detyrimi 2023	Arkëtuar	Debitor
		nr	date			
1	"V " shpk	1	06.07.2023	200.000	200.000	0
2	"D " shpk	8	09.12.2022	200.000	200,000	
3	"A "shpk		06.12.2023	200.000	200.000	0
4	"C " shpk		Ne proces gjyqësor			
5	"P " shpk	5	19.09.2022	20.000	20,000	

6	"F " shpk	11	24.11.2020	100.000 ³	100.000	0
7	S shpk	3	27.06.2022	200.000	200,000	
8	"A " shpk	1	10.02.2020	1.000.000 ⁴		
9	"B " shpk		04.11.2023	200.000		200,000
10	"R "shpk	2	12.04.2022	200.000		200,000
11	"B "shpk		07.04.2022	200.000		200,000
12	"A " shpk	2	29.05.2023	200.000	200,000	0
13	"Q " shpk	2	27.09.2023	200.000	200,000	0
14	"M " shpk	8	13.07.2020	200.000		200,000
15	"T " shpk	5	17.10.2023	200.000	200,000	0
	TOTALI			2.220.000	1.420.000	800.000

(Burimi: Drejtoria e Transportit, Bashkia Kuçovë)

Sipas VKB 73/2022, tarifat për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj për: 1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante 1 000 000 Lekë/liçencë 5 vjecare; 2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregimit për përdorim nga konsumatorët fundorë 100 000 Lekë/liçencë 5 vjecare.

Pagesa te kryhet ne menyre perpjestimore: 1/5 e Tarifes para marrjes se licences, dhe cdo fillim viti pasardhes nga 1/5 deri ne realizim te tarifes se plote.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Kuçovë mbi arkëtimin e taksës së licencimit nga 15 subjektet e tregimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Kuçovë dhe në Njësitë Administrative janë kryer pagesa si 1,000,000 lekë.

Konstatim: Nga verifikimi i legjitimitetit për ushtrimin e aktivitetit të tregimit të karburanteve rezultoi se nuk kanë aplikuar për rilicencim, sipas kërkesave të VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa b dhe pika, të pa/njoftuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit bashkia Kuçovë **4 subjekte** përkatësisht: "D " shpk, pa njoftuar; "P " shpk pa njoftuar; S shpk pa njoftuar; "B " shpk pa njoftuar; "R "shpk njoftuar me shkresë nr. 1910 prot, datë 07.06.2023; "M " shpk, njoftuar me shkresë nr. 429 prot, datë 09.02.2022. Nga mos aplikimi për rilicencim për tregtim të karburanteve për konsumator fundorë, nga 4 subjektet e sipërcituar, janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën **800,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ” neni 22, pika 3, germa “dh”.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi:

S.V , ish Drejtor i Drejtorisë së Transportit, aktualisht Drejtor i Drejtorisë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.945/12 prot, datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me nr. 360/2 prot, datë 22.04.2024 prot, datë, nga Z.S.V në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Koordinimit- Zhvillimit Strategjik, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Lidhur me të ardhura nga “**Shitja e mallrave dhe shërbimeve**”, lidhur me subjektet e konstatuar që nuk kanë aplikuar për rilicencim (bashkëlidhur shkresat)informojmë si më poshtë: Subjekti “D ”, ka kryer pagesën për autorizim në shumën 200,000 lekë, datë 15.04.2024 në R (bashkëlidhur observacionit); Subjekti “P ”, ka kryer pagesën për autorizim, datë 12.04.2024(bashkëlidhur observacionit), sipas faturës për arkëtim nr. 30/2024 ne shumën 20,000 lekë; Subjekti “B ”, ka kryer pagesën për autorizim për tregtim karburant (gaz), datë 07.02.2024 në shumën 200,000 në O sipas faturës për arkëtim date 30.11.2023 (bashkëlidhur observacionit); Subjekti “S ” është njoftuar nga Drejtoria e Shërbimeve

³ Nuk është debitor, pasi pasi është kryer totalisht ne vitin 2022

⁴ Nuk është debitor, pasi pasi është kryer totalisht ne vitin 2022

Publike dhe Transportit për përfundimin e afatit të licencës dt 26.06.2023, me shkresën nr.194 prot, dt 17.01.2024 (bashkëlidhur observacionit); Subjekti “B ” shpk, pas komunikimit dhe kontrollit nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Kuçove, rezulton në proces mbyllje aktiviteti; Subjekti “R ”shpk është njoftuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit për përfundimin e afatit licencës për tregtim karburanti datë 11.04.2023 me shkresën nr. 1910 prot, datë 07.06.2023; shkresë nr. 194 prot, datë 17.01.2024; shkresë nr. 1429 prot, datë 18.04.2024, për marrjen e masave ligjore për vjeljen e detyrimit; Subjekti “M ” shpk nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për përfundimin e afatit të licencës dt 12.07.2021 është njoftuar me shkresë nr.2844 prot, datë 30.08.2021; shkresë nr. 429 prot, datë 08.02.2022. Për mos veprim nga ana e subjektit Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit me shkresë nr. 2581 prot, datë 23.08.2022 ka njoftuar Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Policia bashkiake Kuçove u njoftua me shkresë nr. 2070 prot, datë 30.06.2022 (ka mbajtur Akt Kontroll nr. 00343 prot, datë 15.09.2022; Me shkresë nr. 1908 prot, datë 07.06.2023 u njoftua Drejtoria e të Ardhurave për marrjen e masave të mëtejshme ligjore për vjeljen e detyrimit.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur me komentet e bëra nga bashkia Kuçove sqarojmë se personat juridikë, që ushtrojnë në pikat e shitjes së karburanteve, ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante për automjete parashikuara duhet të pajisen autorizimet nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje. Sipas nenit 11, pikat “ç” dhe “d” e ligjit nr.8450/1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftë , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

- Dokumentacioni bashkëlidhur observacionit për pagesat e bëra nga subjektet e tregtimit të karburantit dhe/ose gazi të lëngshëm pas auditimit ne terren nga KLSH, përkatësisht “D ” në shumën 200,000 lekë datë 15.04.2024 në Raiffeisen Bank, subjekti “P ” ne shumën 20,000 lekë datë 12.04.2024 në BKT; nga subjekti “B ”, datë 07.02.2024 në shumën 200,000 në O , ndryshon situatën debitore të tatimpaguesve, **duke ulur detyrimin e papaguar ne total 420.000 lekë**, arsye për të cilën ky koment merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit

- Subjekti/et tregtar “S ”;“B ” shpk; “R ”; “M ” shpk, ushtrojnë aktivitet tregëtar pa licencë, ne kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8450/1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, nenit 25, pika “o” paragrafi “iv” për të cilat secili dënohet me gjobë nga 1,000,000-1,500,000 lekë. Pavarësisht shkresave të sipërcituara në observacion, strukturat bashkiake nuk kanë ezuaruar në kohë vendosjen e penalteteve për kundërvajtje administrative, nuk kanë ezuaruar bllokim veprimtarie për ushtrim të paligjshëm aktiviteti tregëtar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8450/1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftë, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar, neni 25, pika “iv”, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

Nga mos aplikimi për ri licencim të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Kuçovë për vitin 2023 për 4 subjekte mbeten në vlerën **800,000 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8450/1999“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftë, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar, neni 25, pika “i”.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur përsëri observacioni me shkresë nr.945/17 prot, datë 29.05.2024 protokolluar në KLSH me nr. 360/6 prot, datë 31.05.2024 prot, nga Bashkia Kuçovë, ku janë shprehur objeksionet e përsëritura të ardhura në fazën e aktkonstatimeve, të cilat kanë ardhur me vonesë dhe nga grupi i auditimit janë reflektuar në fazën e Raportit Përfundimtar të Auditimit të pasqyruara sa më sipër.

-Tarifa per mirembajte kanale kullues

Kjo Tarifë bazohet ne ligjin 24/2017 date 09.03.2017 “Per Administrimin e Ujitjes e Kullimit”,vendoset per mirembajtjen e kanaleve kullues-vadites, për ato fermere dhe fshatra te njesive administrative qe kane rrjet te kanalizimeve. Tarifa e Mirëmbajtjes se kanaleve kullues do te jete 100 leke/dynymi. Tarifa e Vaditjes, përdoret për ato subjekte qe kërkojnë te vadisin ngastrat e tyre , ne vlere prej 400 leke/dynymi.

Struktura përgjegjëse për faturimin, shpërndarjen dhe arkëtimin e kësaj tarife, do te jene Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Njësitë Administrative respektive.

Realizimi të ardhurve nga shitja mallra dhe shërbimeve u realizua 1,059 mijë lekë ose 1,271 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 2,330 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 45.47%.

-Te tjera tarifa

Ta ardhura nga tarifa si certifikatë përdorimi, tatim i thjeshtuar i BV, tarife për mirëmbajtje varreza, të ardhura nga parkingu, tarifë tabelle, leje transporti, taksë reklame, taksë fjetje në hotel, tarifë për shfrytëzim lëndë drusore, tarife vendore për kontroll territori, tarifë për piketim objekti, tarifë therje bagëtie, takse vendore për ujin, tarife vendore për vërtetime, të ardhura nga MNZ, energji tregu.

Realizimi të ardhurve nga “tarifa të tjera” të sipërcituara, u realizua 2,740 mijë lekë ose 1,208 mijë lekë më pak se parashikimi buxhetor 3,948 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 69.40%.

-Te ardhura nga gjoba dhe sekuestrime

Ne funksion të mirëadministrimit të tarifave dhe taksave vendore, administrata e bashkisë Kuçovë ka përdorur masa administrative dhe masa shtrenguese për respektimin e detyrimeve tatimore që burojnë nga kjo paketa fiskale 2023 si dhe në mbeshtetje të ligjit 9632 datë 30.10.2006, “Për Taksat Vendore” i ndryshuar, Kreu VI Neni 34, Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSh” i ndryshuar, ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”.

Realizimi të ardhurve nga gjoba dhe sekuestrime u realizua 7,288 mijë lekë ose 4,795 mijë lekë më shumë se parashikimi buxhetor 2,493 mijë lekë në PBA 2023 ose realizuar 292.31%. Gjithsesi të ardhurat nga gjobat për biznesin e madh dhe biznesin e vogël janë realizuar 1,955 mijë lekë ose 80% e penaliteteve të vendosura.

Peshën më të madhe në këto të ardhura e zënë të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime në shumën 5,324 mijë lekë për 31 gjoba të vendosura nga Inspektorati Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe të ekzekutuara nga përmbaruesi gjyqësor gjatë vitit 2023.

-Të ardhura nga debitorë

Bashkia Kuçovë me VKB Nr. 73 datë 30.11.2022 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Vitin 2023” ka planifikuar të gjenerojë të ardhura në shumën **15,000 mijë lekë** nga arkëtimi i debitorëve. Arkëtimi i debitorëve u realizua **17,501 mijë lekë** të ardhura nga tarifa dhe taksa vendore, duke rezultuar me rritje të ardhurash për 2,501 mijë lekë ose **realizuar 116.67%**. Për Vitin 2023 janë arkëtuar debitorë nga biznesi i madh dhe i vogël 2,519 mijë lekë, debitorë nga tatim tokë 12,575 mijë lekë, debitorë familjarë 1,946 mijë lekë, debitorë qira toke 128 mijë lekë, të tjerë 340 mijë lekë.

2.2.6.4 Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve.

2.2.6.5 Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023.

Referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4 përcakton se “*Bashkitë dhe organet tatimore të pushtetit qendror i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e çdo akt tjetër detyruar për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për aq sa këto të fundit nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”.*

Ndërsa neni 34, i po këtij Ligji citon se “*Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

Neni 12 i Ligjit nr. 168/2017 “Për financiar e Vetëqeverisjes Vendore” përcakton se “*Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë, mbajnë dhe përditësojnë Regjistrin e Personave Fizikë dhe*

Juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifatat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore...”

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore në vlerën gjithsej 98,362,721 lekë, janë debitorë 409 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 24,187,702 lekë dhe 3736 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën 74,175,019 lekë, në mënyrë të përmbledhur pasqyra e debitorëve si më poshtë:

Debitorëve për taksat e tarifa me datë 31.12.2023 (në lekë)

Nr	Emërtimi	Numër subjektësh	Gjithsej
	Gjendja me 31.12.2022	3,979	96,561,213
1	Biznesi	400	21,538,392
2	Institucione	1	1,236,527
3	Familjar (për taksat dhe tarifa vendore)+toka bujqësore	3,578	73,786,294
4	Krijuar gjatë vitit 2023	3,987	17,841,230
5	Biznese	110	3,931,686
6	Familjarë	3,877	13,909,544
7	Pagesat gjatë vitit 2023	3,822	16,039,722
8	Biznese	103	2,518,903
9	Familjarë	3,719	13,520,819
10	Gjendja me 31.12.2023	4,145	98,362,721
11	Biznesi	408	22,951,175
12	Institucione	1	1,236,527
12	Familjar (për taksat dhe tarifa vendore)+toka bujqësore	3,736	74,175,019

(Burimi: DAV Bashkia Kuçovë)

Nga të dhënat e pasqyrës **rezultoi se debitorët** e vitit 2023 me vitin 2022 **janë në rritje** si në numër ashtu dhe në vlerë, kështu debitorë për vitin 2023 të biznesit dhe familjarë janë 4145 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh e familje në vlerën 98,362,721 lekë, krahasuar me vitin 2022 që kanë qenë 3979 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh e familje në vlerën 96,561,213 lekë, me rritje për vlerën 1,801,508 lekë.

Për debitorët e mësipërm për kategorinë biznes dhe institucione, nga DAV Bashkia Kuçovë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, janë aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), pa ezauruar masa shtrënguese në mënyrë shteruese të tilla si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal, sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreun XI.

Në këtë kuadër, rezulton se nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nuk janë marrë masa shteruese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura ndër vite të debitorëve si dhe rezulton shtim i debitorëve më shumë sesa pakësim i tyre. Këto kanë sjell efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura përgjatë vitit 2023 dhe mungesë e arkëtimit të debitorëve të krijuar gjatë viteve në vlerën totale **98,362,721**lekë, për shkak të mos marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura lidhur me taksat dhe tarifatat vendore.

Konkluzion: Nga auditimi dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave Lokale, Bashkia Kuçovë konstatohet se në fund të periudhës 2023 janë gjithsej debitorë **në vlerën 98,362,721 lekë** nga të cilët 409 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 24,187,702 lekë dhe 3736 familje për taksat toke, taksat ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën 74,175,019 lekë. Në fundvitin 2023 ndryshimi i gjendjes debitorë për taksat dhe tarifa vendore krahasuar me fillimin e vitit është shtuar me **1,801,508 lekë**. Nga auditimi nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve. Rritja e gjendjes debitorë ka ardhur si pasojë e mos marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për taksat dhe tarifatat vendore, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e

detyrimin tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi:

z. S.L , përgjegjës Sektori të Ardhurave, bashkia Kuçovë.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.945/13 prot, datë 19.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 360/3 prot, datë 22.04.2024 prot, datë, nga Z.S.L , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Lidhur me “Debitorë” ju bëjmë me dije se Drejtoria e të Ardhurave në zbatim të Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Kreu XI, nenin 89, Pika 2, ka bërë bllokime bankare dhe RBS. Për marrjen e masave shtrënguese është aplikuar në e-albania në vitin 2022 dhe në vitet e mëparshme i jemi drejtuar me shkresë ASHK. Aplikimi në e-albania edhe pse është i kushtueshëm nuk ka dhënë rezultat, ndërsa bllokimi bankar dhe RBS kanë dhënë rezultat.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga auditimi rezultoi se nga ana e Sektorit të të Ardhurave bashkia Kuçovë nuk janë marrë masa shtrënguese dhe shteruese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura ndër vite të debitorëve si dhe debitorëve të rinj, me efekt rritjen e detyrimeve të prapambetura në 31.12.2023 në vlerën totale **98,362,721**lekë. Ndryshimi i gjendjes debitore për taksa dhe tarifa vendore në fund të vitit 2023 krahasuar gjendjen në fillim të vitit është shtuar me **1,801,508** lekë si pasojë e mos marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për taksa dhe tarifata vendore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreun XI, arsye për të cilën komenti nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pika. 2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023.

Për vitin 2023, Në përputhje me kërkesat e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” si dhe të UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 1084 prot., datë 20.03.2024, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë, Nëpunës autorizues.

Mbajtja e kontabilitetit v. 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditaret përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Kuçovë; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme: Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 1,465,969,099 lekë.

Aktivet	1,714,913,996 lekë
Pasivet	248,944,897 lekë
Aktivet neto	1,465,969,098 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **330,248,244 lekë** dhe përbëhen nga:
 Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 108,622,672 lekë,
 Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 7,546,598 lekë,
 Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 193,629,558 lekë,

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare ne bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	108,622,672	81,229,758	27,392,914
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		108,622,672	81,229,758	27,392,914

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 108,622,672 lekë, sipas akt akordimit me Thesarin përbëhet nga: gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” paraqitet në vlerën 76,801,693 lekë (të ardhura të trashëguara të paçelura 33,251,062 lekë, grandit papërdorur në vlerën 38,414,620 lekë dhe të ardhura të papërdorura në vlerën 2,091,077 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 34,865,919 lekë, minus Ndryshimin e gjendjeve të inventarit që në fund të vitit paraqitet me shtesë në vlerën 3,044,946 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË), sipas të dhënave të pasqyrës **Aneks 1/3 bashkëlidhur.**

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	2,791,200	1,444,929	1,346,271
32	Inventar i imet	4,755,398	3,056,723	1,698,675
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretteve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0

39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	Totali	7,546,598	4,501,652	3,044,946

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kuçovë në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 7,546,598 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,791,200 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 4,755,398 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën 3,044,946 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën –(3,044,946) lekë. **Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 2,791,200 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe akt rakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	1,444,929
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	11,476,125
Dalje nga magazina gjatë vitit	10,129,854
Gjendja në 31.12.2023	2,791,200

Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 4,755,398 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe akt rakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	3,056,723
Hyrje gjatë vitit 2023	1,902,004
Dalje gjatë vitit 2023	
Gjendja në 31.12.2023	4,755,398

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Mbi inventarizimin e aktiveve qarkulluese dhe Afatgjata materiale.

Inventarizimi fizik i aktiveve qarkulluese dhe aktiveve afatgjata materiale për vitin 2023 është kryer nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 340, datë 01.12.2023 i përbërë nga tre anëtarë gjatë muajit Dhjetor. Nga inventarizimi fizik i kryer është konstatuar aktive qarkulluese dhe aktive afatgjata materiale që janë jashtë funksionit në bazë të relacionit të paraqitur nga komisioni i inventarizimit më datë 31.01.2024, nga e cila llogaria 327 në vlerë 153,682 lekë, llogaria 214 në vlerë 110,400 lekë, llogaria 215 në vlerë 1,200,000 lekë dhe llogaria 218 në vlerë 758,542 lekë, për të cilat për periudhën objekt auditimi nuk ka procedurë të nxjerrjes jashtë përdorimit.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit 2023, me urdhrin e brendshëm nr. 30, datë 29.08.2023 të Kryetarit të bashkisë është bërë miratimi i procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimi i aktiveve qarkulluese të llogarisë 327 “Inventarë i imët” në vlerën 203,329 lekë, aktive afatgjata materiale llogaria 218 “Inventarë ekonomik”, në vlerën 1,389,502 lekë, të cilat janë vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të ngritur me urdhrin nr. 133, datë 05.06.2023 dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi i ngritur me urdhrin nr 138, datë 05.06.2023, për aktive materiale që janë vlerësuar për jashtë përdorimit në vitin 2022.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme	193,629,558	201,172,499	(7,542,941)
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione te tjera publike	0	0	0
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	166,758,021	165,531,218	1,226,803
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	26,871,537	35,641,281	(8,769,744)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0		
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0		
	Të tjera aktive afatshkurtra	20,449,416	177,549,057	(157,099,641)
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0		
477	Diferenca konvertimi aktive	0		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0		
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	20,449,416	177,549,057	(157,099,641)

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 166,758,021 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	165,531,218
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	22,354,066
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	21,127,263
Gjendja në 31.12.2023	166,758,021

Vlera e debitorëve ne vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 1,226,803 lekë. Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në pasqyrën **Aneks 2/3 bashkëlidhur.**

Konstatimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 166,758,021 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton se në kredi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën 23,447,723 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 26,871,537 lekë.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 20,449,416 lekë.

Këto llogari përfaqësojnë llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore dhe kreditorë të ndryshëm.

Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 40,659,182 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 37,813,039 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 54,190,199 lekë.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në pasqyrën **Aneks 3/3 bashkëlidhur**.

Konstatimi: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “*Studime dhe projekte*”, konstatohet se, kjo llogari është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 6,235,200 lekë projekt i vënë në zbatim për objektin “Rikonstruksion i rrugës Kuçovë-Ura Vajguore” gjithashtu në këtë llogari vlera prej 1,359,400 lekë është e pa analizuar dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaria 210 “Toka,troje Terrene” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 351,142 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 351,142 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 351,142 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 351,142 lekë.

Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 100,555,555 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 116,696,635 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 140,883,628 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 163,166,636 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 38,779,550 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për objektet si më poshtë:

-Objekti “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfër” në vlerën 15,203,703 lekë, sipas kontratës nr. 3387, datë 08.10.2021, me vlerë 15,253,676 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi sipas pasqyrës **Aneks 4/3 bashkëlidhur**.

-Objekti “Ndërtim banesa sociale kati II-të” në vlerën 22,742,039 lekë, sipas kontratës nr. 3104, datë 10.10.2022 me vlerë 22,753,839 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi sipas pasqyrës **Aneks 5/3 bashkëlidhur**.

- Objekti “Rikonstruksioni i shkollës Koço Korçari” në vlerën 833,808 lekë, sipas kontratës nr 722, datë 27.02.2023 me vlerë 833,826 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi sipas pasqyrës **Aneks 6/3 bashkëlidhur**.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 kemi pakësim në vlerën 16,496,542 lekë si rezultat i transferimeve pa pagesë “Përmirësimi i banesave të komuniteteve të varfër” në vlerën 15,203,703 lekë si dhe transferuar Qendra Ekonomike e Arsimit Objekti “ Rikonstruksioni i shkollë “Koço Korçari” në vlerën 833,808 lekë dhe Objekti “Rikonstruksioni i shkollave Tapi e Sheqëz’ në vlerën 459,031 lekë , sipas shkresës nr.326, datë 29.01.2024 .

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet sipas pasqyrës **Aneks 7/3 bashkëlidhur**.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria **212 “Ndërtesa konstruksione”** sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 163,166,636 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, është kontabilizuar gabim vlera prej 7,992,306 lekë për (Sistemim varreza fshati Perondi në vlerën 3,342,353 lekë, Sistemim varreza fshati Tapi në vlerën 3,989,032 lekë dhe Ndërtim mur mbajtës fshati Perondi Kuçovë në vlerën 660,921 lekë) që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 210 “Toka,troje Terrene”, gjithashtu në këtë llogari nuk është zbritur vlera për 7 ndërtesa ambulanca në fshatrat Demollar, Perondi, Tapi, Goraj dhe Magjat në vlerën 3,857,909 lekë që janë objekte të cilat i përkasin DRSHSH, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022,Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 605,649,827 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 711,097,326 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 747,461,215 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 884,316,342 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 136,855,127 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM për objektet si më poshtë:

-Objekti “Rikonstruksion i rrugës “Murat Daulle’ në vlerën 22,457,741 lekë, sipas kontratës nr. 116, datë 14.01.2021 me vlerë 44,324,040 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 122, datë 09.02.2023 vlera 22,457,741 lekë për faturën nr. 7, datë 26.02.2022, likuiduar me Urdhër shpenzimi sipas pasqyrës **Aneks 8/3 bashkëlidhur.**

-Objekti “Devijimi i Përroit Gegë” Kolaudim në vlerën 45,000 lekë, sipas kontratës nr. 3683, datë 30.11.2022 me vlerë 54,000 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 233, datë 04.04.2023 vlera 45,000 lekë për faturën nr. 4, datë 20.03.2023.

-Objekti ”Rikualifikim urban i Lagjes Ll.Prifti” në vlerën 77,164,680 lekë, sipas kontratës nr. 435, datë 04.02.2021 me vlerë 77,164,680 lekë, Supervizion në vlerën 480,352 lekë , sipas kontratës nr. 435/1, datë 04.02.2021 , Kolaudim në vlerën 88,800 leke , sipas kontratës nr. 1283, datë 11.04.2023 likuiduar me Urdhër shpenzimet sipas pasqyrës **Aneks 9/3 bashkëlidhur.**

-Objekti “Rikualifikim urban Sheshi i Kombinatit “11 Shkurti” në vlerën 18,079,911 lekë, sipas kontratës nr. 545, datë 10.02.2023 me vlerë 29,628,037 lekë, Kolaudim në vlerën 33,000 leke , sipas kontratës nr. 2787 , datë 21.08.2023 me vlerë 39,600 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimet sipas pasqyrës **Aneks 10/3 bashkëlidhur.**

-Objekti “Rikonstruksion rruga Ferras” në vlerën 10,499,043 lekë, sipas kontratës nr. 1363, datë 18.04.2023 me vlerë 16,672,800 lekë, Supervizion ne vlerën 199,908 lekë, sipas kontratës nr 1363/1 datë 18.04.2023 me vlerë 199,908 lekë, Kolaudim në vlerën 31,200 leke , sipas kontratës nr. 2766 , datë 21.08.2023 me vlerë 31,200 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimet sipas pasqyrës **Aneks 11/3 bashkëlidhur.**

-Objekti “Rikonstruksion rruga Havaleas” në vlerën 8,039,600, lekë, sipas kontratës nr. 1841, datë 08.06.2023 me vlerë 18,186,960 lekë, , Kolaudim në vlerën 39,600 leke , sipas kontratës nr. 3670 , datë 30.10.2023 me vlerë 39,600 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimet sipas pasqyrës **Aneks 12/3 bashkëlidhur.**

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet sipas pasqyrës **Aneks 13/3 bashkëlidhur.**

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” sipas Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 747,461,215 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 884,316,342 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera për 2 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 28,866,405 lekë (KUZ lagja 11 janari në vlerën 9,751,014 lekë dhe KUZ lagja 1 maji në vlerën 19,115,391 lekë) që janë transferuar UK Kuçovë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, paraqiten në vlerën 646,530 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 517,224 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 2,974,713 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 2,974,713 lekë.

Kjo llogari është shtuar për vitin 2022 në vlerën 411,099 lekë për blerje me pagesë si më poshtë:
-Objekti “Skene për Kulturën në vlerën 411,099 lekë, sipas faturës nr. 15, datë 25.10.2023. me vlerë 411,099 lekë dhe FH nr. 51, dt 25.10.2023 në vlerë 411,099 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 824, datë 02.11.2023 vlera 180,000 lekë financuar nga granti i bashkisë dhe shuma prej 231,099 lekë financuar nga fondet e BE sipas njoftim debitimi nr. P231106AI3OOP08 datë 06.11.2023 në R Kuçovë.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 kemi pakësim në vlerën 411,099 lekë transferuar tek Qendra Kulturore me shkresë nr. 3720, datë 01.11.2023.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet sipas pasqyrës **Aneks 14/3 bashkëlidhur.**

Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 23,497,753 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 29,938,203 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 48,175,756 lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 35,455,756 lekë. Kjo llogari është shtuar për vitin 2023 në vlerën 12,720,000 lekë për blerje me pagesë si më poshtë:

-Makinë Opel ANTARA në vlerën 960,000 lekë, sipas kontratës nr. 97, datë 11.01.2023 me vlerë 960,000. lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 152, datë 24.02.2023. vlera 960,000 lekë për faturën nr. 6, datë 09.02.2023.

-Makinë Ford Kruga në vlerën 960,000 lekë, sipas kontratës nr. 97, datë 11.01.2023. me vlerë. 960,000 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 151, datë 24.02.2023 vlera 960,000 lekë për faturën nr. 5, datë 09.02.2023.

-Makinë Zjarrfikëse në vlerën 10,800,000 lekë, sipas kontratës nr. 912, datë 09.03.2023. me vlerë 10,800,000 lekë për faturën nr. 97, datë 29.05.2023, likuiduar me Urdhër shpenzimet sipas pasqyrës **Aneks 15/3 bashkëlidhur.**

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet sipas pasqyrës **Aneks 16/3 bashkëlidhur.**

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,736,921 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,103,137 lekë. Ndërsa

sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 është e analizuar për 586 artikuj kontabël në vlerën 21,388,975 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 për 595 artikuj në vlerën kontabël 20,923,473 lekë.

Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 959,000 lekë

-Blerje pajisje zyre (kompjuter printer dhe fotokopje) në vlerën 770,000 lekë, sipas faturës nr. 47, datë 15.05.2023 dhe FH. nr. 23 datë 15.05.2023 likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 381 , datë 22.05.2023 vlera 770,000 lekë për faturën nr. 47 , datë 15.05.2023.

-Blerje pajisje zyre (kompjuter printer dhe fotokopje) në vlerën 189,000 lekë, sipas faturës nr. 199, datë 06.11.2023 dhe FH. nr. 53 datë 06.11.2023 likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 909 , datë 05.12.2023 vlera 189,000 lekë për faturën nr 199, datë 06.11.2023.

Është pakësuar për vlerën kontabël 1,389,502 lekë nxjerrje jashtë përdorimit me Vendim të Kryetarit nr. 30, datë 29.08.2023, si dhe 35,000 lekë te transferuara ne QEA me shkresën nr. 132, datë 11.01.2024.

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr. 7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF, paraqitet sipas pasqyrës **Aneks 17/3 bashkëlidhur.**

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga 3504 prona të transferuara me VKM, një pjesë e konsiderueshme prej 3372 nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe Pasqyrën e Pozicionit Financiar “Aktivet afatgjata material”, Gjithashtu ka rezultuar se nga 186 objekte inventari të pasurive të paluajtshme, Bashkia Kuçovë për 4 objekte janë pajisur me titull pronësie, ndërsa për **182 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie**, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kuçovë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (272,581,555) lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (48,922,075) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat:

Llog. 202 Amortizim i studimeve e kërkimeve 2,842,143 lekë

Llog. 212 Ndërtime e konstruksione 6,925,065 lekë

Llog. 213 Rruge rrjete vepra ujore 31,407,628 lekë

Llog. 214 Instalime teknike, pajisje, vegla pune 129,306 lekë

Llog. 215 Mjete transporti 6,279,550 lekë

Llog. 218 Inventari ekonomik 1,334,383 lekë

Pakësimi në vlerën 1,949,238 lekë

Llog. 212 Ndërtime e konstruksione 783,137 lekë, për transferime të brendshme,

Llog. 218 Inventari ekonomik 1,166,101 lekë, nga nxjerrjet jashtë përdorimit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Kuçovë, janë si më poshtë: ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje

inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %

për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25 %

për mjetet e transportit 20 %

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se **Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, Bashkia nuk ka ndërmarrë procedurë sipas përcaktimeve të ligjit nr 79/2017 “Për sportin” ndryshuar me ligjin nr 105 “Për sportin”, datë 29.07.2020 neni 22, ku përcaktohet.....pika 1. *Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pika 2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare.* Për sa kohë që nuk është shitur duhet që në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” të pasqyrohet 100% në kapitalin e aksioneve tek Klub Sport “N” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022.

Llogaria 231 “AAGJM Investime në proces” paraqitet në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 260,601,605 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 483,149,045 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2023. Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave paraqitet sipas pasqyrës **Aneks 18/3 bashkëlidhur.**

Konstatimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 483,149,045 lekë, në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se për vitin 2023 ka kontrata që kanë përfunduar si punime të cilat duhej të kapitalizoheshin në llogaritë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për objektin “Ndërtim Ujësjellësi në fshatrat Lumas etj” në vlerën 426,976,583 lekë, pra vlera e llogarie 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, është raportuar e mbivlerësuar pra nuk është kryer veprimi kontabëlizimit në grupin 20 e 21 të aktiveve të përfunduara, veprime në kundërshtim Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Aneksi 1, Klasa 23.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kuçovë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	9,922,981	22,356,873	(12,433,892)
42	Detyrime ndaj personelit	7,284,948	6,141,858	1,143,090
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	514,887	397,269	117,618
435	Sigurime shoqërore	2,155,012	1,788,717	366,295
436	Sigurime shëndetësore	299,065	249,033	50,032
437,438	Organizma të tjerë shtetrorë	76,161	52,454	23,707
464	Detyrime për tu paguar për bl. letrave me vler	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	34,865,919	15,166,491	19,699,428
467	Kreditorë të ndryshëm	27,067,903	182,204,138	(155,136,235)

4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	552,838	552,838	0
475	Të ardhura për tu rregjistruar vitet pasardhëse	166,205,183	164,978,380	1,226,803
	Gjendja më fund të periudhës	248,944,897	393,888,051	144,943,154

Llogaria 401-408, “Furnitorë e llogari te lidhura me to”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 9,922,981 lekë dhe përfaqëson vlerën e faturave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës e analizuar, sipas pasqyrës **Aneks 19/3 bashkëlidhur.**

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 7,284,948 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Celje e vitit 2023	6,141,858
Shtesa (K)	7,284,948
Pakësime (D)	6,141,858
Gjendja në 31.12.2023(K)	7,284,948

Sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, të dhënat në pasqyrën **Aneks 20/3 bashkëlidhur.**

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 514,887 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Celje e vitit 2023	397,269
Shtesa (K)	514,887
Pakësime (D)	397,269
Gjendja në 31.12.2023 (K)	514,887

Sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, të dhënat në pasqyrën **Aneks 21/3 bashkëlidhur.**

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 që paguhet në muajin janar 2024 dhe janë përkatësisht në vlerat 2,155,012 lekë dhe 299,065 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Celje e vitit 2023	1,788,717
Shtesa	2,155,012
Pakësime	1,788,717
Gjendja në 31.12.2023	2,155,012
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Celje e vitit 2023	249,033
Shtesa	299,065
Pakësime	249,033
Gjendja në 31.12.2023	299,065

Sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2024, të dhënat në pasqyrën **Aneks 22/3 bashkëlidhur.**

Llogaria 437,438 “Organizma të tjerë shtetërorë”, raportuar për vlerën 76,161 lekë të cilat përfaqësojnë “Sigurimi vullnetar” që paguan kryetari bashkisë dhe punonjësit e sektorit të MNZ.

Llog. 438 "Organizma të tjerë shtetërorë"	
Celje e vitit 2023	52,454
Shtesa (K)	76,161
Pakësime (D)	52,454
Gjendja në 31.12.2023 (K)	76,161

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,166,491 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 34,865,919 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike e cila paraqitet, sipas pasqyrës **Aneks 23/3 bashkëlidhur.**

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten detyrimet për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykatë të cilat për vitin 2023 paraqiten në vlerën 27,067,903 lekë, në mënyrë analitike paraqiten sipas pasqyrës **Aneks 24/3 bashkëlidhur.**

Konstatimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është pasqyruar në vlerën 27,067,903 lekë nga auditimi ka rezultuar se nuk janë evidentuar si detyrime të pa likuiduara vlera prej 15,442,402 lekë, që i përkasin faturës nr. 65, datë 06.11.2023 për vlerën 10,186,960 lekë e operatorit “**B ” shpk** për kontratë nr 193, datë 08.06.2023 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Havakleas” dhe faturë nr 25, datë 01.09.2023 për vlerën 5,357,442 lekë e operatorit “**B ” shpk** për kontratë nr 545, datë 10.02.2023 “Rikualifikim i sheshit të Kombinatit”. Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për kryerje investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2023, për vlerën **15,442,402 lekë**, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve, veprime në kundërshtim me Udhëzimet e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, për vitin 2023 është e pasqyruar, për vlerën 552,838 lekë, e cila përfaqëson detyrime e tretëve që kanë ndaj Bashkisë.

Llogaria 475 “Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse”, përfaqëson vlerën e debitorëve të ndryshëm që për vitin 2023 është e pasqyruar, për vlerën 166,205,183 lekë të analizuar në aktiv të bilancit..

Fondi i konsoliduar për vitin 2022, sipas formatit nr.1 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,465,969,098	1,108,263,431
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,383,629,645	1,037,590,389
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	76,801,693	65,135,282
111	Rezerva	0	0
115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	0
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime	0	0
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	0	0
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	5,537,760	5,537,760
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
	Te Tjera	0	0

Analizë: Formati nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën **719,969,398 lekë**, paraqitet si më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **97,904,957 lekë**, e analizuar:

Tatim mbi të ardhurat në vlerën 148,899 lekë,
Tatim mbi pasurinë në vlerën 15,122,136 lekë,
Tatim mbi mallrat e shërbimet brenda vendit në vlerën 82,633,922 lekë.
Gjendja e llogarisë sintetike 71 “Të ardhura jo tatimore” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën **80,196,739 lekë**, e analizuar:

Nga N t dhe pronësia në vlerën 2,636,879 lekë,
Tarifë administrative dhe rregullatorë në vlerën 64,391,010 lekë,
Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh në vlerën 4,789,690 lekë,
Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve në vlerën 1,091,000 lekë,
Gjoha kamatvonesa sekuestrime e zhdëmtime në vlerën 7,288,160 lekë.
Gjendja e llogarisë sintetike 7 “Grande korrente” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **541,867,702 lekë**, e analizuar:

Nga buxheti për NjQP (Qendrore) në vlerën 213,793,021 lekë,
Nga buxheti për NjQP (Vendore) në vlerën 278,640,761 lekë,
Pjesëmarrje e institucioneve në tatim taksa në vlerën 32,343,380 lekë,
Financim i pritshëm nga buxheti në vlerën 17,090,540 lekë.
Analiza e shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën **643,167,705 lekë** paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 97,564,254 lekë.

Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 15,722,588 lekë.

Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 71,095,880 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korrente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 255,780,956 lekë.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 206,048,970 lekë.

Për vitin 2022 totali i te ardhurave në vlerë është 719,969,398 lekë dhe totali shpenzimeve është 643,167,705 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 210,571,173 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultatit e ushtrimit “i cili paraqitet në vlerën 76,801,693 lekë.

Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. U krye verifikimi i likuidimeve të kontratave për mallra, shërbime e punime ndërtimi ku rezultoi se ato janë kryer brenda afateve të paraqitjes së faturës për të cilën Drejtoria e Financës ka plotësuar urdhër-shpenzime për likuidimin e tyre.

Për sa më sipër mbahet ky akt konstatimi me znj. H.SH me detyrë Drejtore e Financës dhe Buxhetit, për periudhën e auditimit.

Nënpika 2.3.4. Auditim mbi administrimin e pyjeve, dhe dhënia me qira e tyre.

Në zbatim të nënpikës 3.4 mbi “Menaxhimin e asetëve, inventari dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, të programit të auditimit nr. 189/1 datë 20.02.2024, janë administruar evidencat si më poshtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Kuçovë;
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastër;
- Inventari i fondit pyjor;
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor.

I. PASURITË E PALUAJTSHME

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Kuçovë, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 662 datë 08.10.2004 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kuçovë”, ndryshuar me :

- Me VKM nr. 1534, datë 19.11.2008 janë shtuar pronat me nr. 557-567 me funksion ekonomik dhe për strehim.
- Me VKM nr. 539, datë 27.7.2016 janë shtuar pronat e llojit “ kënde lojërash” me nr. 568-570.
- Me VKM nr. 43, datë 30.1.2019 janë shtuar pronat me funksion strehim nr. 571–577, troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet banesave/objekteve nr.572, 574, 575 dhe prona që shërbejnë në fushën e infrastrukturës me nr. 573.
- Ndryshimi i fundit është bërë me VKM nr. 690 datë 18.11.2021 “ Për transferimin në pronësi të Bashkisë Kuçovë të pasurive me funksion rekreative me nr. 6/570 me sipërfaqe 11,300 m² truall dhe 2830 m² ndërtesë si dhe me nr. 6/571 me sipërfaqe 609 m² truall.

Në total, nga 3504 prona që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Kuçovë, përfshirë ish-komunat, vetëm 118 pasuri janë regjistruar sipas tabelës si mëposhtë:

	Bashkia/Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Në pronësi	Në përdorim	Prona të regjistruara në Kadastër
1	Bashkia Kuçovë	280	235	45	117
2	NJA. Perondi	1529	1468	61	1
3	NJA. Kozare	724	688	36	
4	NJA. Lumas	1132	1113	19	
	Totali	3665	3504	161	118

Nga 118 pasuritë që janë të regjistruara rezulton se 63 janë pasuri të llojit apartamente. Për pronat e ish-komunës Perondi rezulton e regjistruar vetëm 1 shkollë ndërsa për ish-komunat Kozare dhe Lumas nuk është regjistruar asnjë pasuri.

Në lidhje me pronat në përdorim, ato kryesisht përfshijnë troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve për Bashkinë Kuçovë, ndërsa për ish-komunat, njësitë administrative pronat në përdorim janë prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).

Prona që përdoren në fushën e arsimit janë:

Bashkia/Njësia	Prona	Regjistruar
Bashkia Kuçovë	24	1
Njësia administrative Kozare	9	-
Njësia administrative Perondi	16	1
Njësia Administrative Lumas	14	-
Totali	63	2

Në lidhje me pronat në fushën e arsimit konstatohet se nga 63 pasuri, janë regjistruar vetëm 2. Konkretisht, rezulton se në Bashkinë Kuçovë nga 24 prona, përfshirë kopshtet dhe çerdhet është

regjistruar pasuria “shkollë+qendra kulturore” ndërsa në njësinë administrative Perondi, nga 16 pasuri gjithsej është regjistruar 1 pasuri e llojit shkollë.

Konstatimi: Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

Në total, nga 3504 prona që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Kuçovë, përfshirë ish-komunat, vetëm 118 pasuri janë regjistruar. Në veçanti konstatohet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to janë realizuar investime përgjatë viteve.

Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi ligjit nr. 20/2020. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron.

Nga Bashkia Kuçovë nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara.

II. Fondi Pyjor Bashkia Kuçovë ka në administrim një fond pyjor dhe kullosor prej 4360.1 ha, i ndarë në 2 ekonomi pyjore dhe 2 ekonomi kullosore, sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Sipas llojit, fondi pyjor përbëhet:

Pyll	3634 ha
Djerrë	277.7 ha
Bimësi Pyjore	240.74
Inproduktive	88.3 ha
Kullotë	360,1 ha

Nga auditimi ka rezultuar se

Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia e Kuçovës nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore si dhe nuk është regjistruara asnjë sipërfaqe pyjore, nga 412 ngastra të transferuara.

Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr. 443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor publik.

Në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Kuçovë nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

II.1 Aktivitetet në fondin pyjor. Në bashkinë e Kuçovës janë lidhur 26 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, nga të cilat 24 kontrata kanë si objekt aktiviteti “mbjellje bimësh” me afat 1 vjeçar me të drejtë rinovimi, ndërsa 2 kontrata kanë si objekt “mbarështimin e fidanëve” me afat 10 vjeçar, lidhur në vitin 2019.

Nga auditimi rezultoi se për 26 kontrata të rinovuara në vitin 2023, qiraja vjetore për hektar është lidhur në vlerën 18000 lekë, dhe jo në vlerën 19,800 sipas çmimit të VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. Si pasojë, rezulton një diferencë nga të ardhurat për qiratë në fondin pyjor në vlerën 32,428 lekë. Në kundërshtim me pikën 10 të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, kontratat e qirave nuk kanë ndjekur procedurën e konkurrimit publik(janë lidhur me kërkesa) si dhe nuk administrohen dosje individuale ku të jenë përcaktuar:

- kërkesa së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- ekstrakti regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- projekti teknik i hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;

TABELA 1- PËRLLLOGARITJA E TARIFAVE PËR KONTRATAT E QIRASË NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR

Nr	Emër mbiemër	Sipërfaqja (ha)	Vlera (leke)	Ekonomia pyjore	Aktiviteti	Duhej përlllogaritur	Diferenca
1	R.B	0.5*18000	9000	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.5*19800=9900	900
2	G.B	0.97*18000	17460	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.97*19800=19206	1746
3	L.B	0.6	10800	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.6*19800=11800	1000
4	P.M	0.18	3240	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.18*19800=3564	324
5	L.P	0.52	9360	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.52*19800=10296	936
6	A.T	0.4	7200	Mali Kozares	Bime 1vjecare	19800*0.4=7920	720
7	S.B	0.2	3600	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.2*19800=3960	360
8	K.H	0.21	3780	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.21*19800=4158	378
9	S.H.H	0.21	3780	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.21*19800=4158	378
10	F.G	1.5	27000	Mali Kozares	Bime 1vjecare	1.5*19800=29700	2700
11	D.M	2.7	48600	Mali Kozares	Bime 1vjecare	2.7*19800=53460	4860
12	M.B	0.35	6300	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.35*19800=6930	630
13	R.T	2	36000	Mali Kozares	Bime 1vjecare	2*19800=39600	3600
14	N.L	0.45	8100	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.45*19800=8910	810
15	P.L	0.7	12600	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.7*19800=13860	1260
16	F.M	0.93	16740	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.93*19800=18414	1674
17	J.A	0.88	15840	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.88*19800=17424	1584
18	F.M	1.5	27000	Mali Kozares	Bime 1vjecare	1.5*19800=29700	2700
19	P.R	0.4	7200	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.4*19800=7920	720
20	A.T	0.5	9000	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.5*19800=9900	900
21	R.T	0.52	9360	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.52*19800=10,296	936
22	A.G	1.05	18900	Mali Kozares	Bime 1vjecare	1.05*19800=20790	1890
23	I.P	0.25	4500	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.25*19800=4950	450
24	N.M	0.54	9720	Mali Kozares	Bime 1vjecare	0.54*19800=10692	972
25	M.GJ ("2 kontrata)	6.9	86250	Mali Kozares	Mbarështrim plep	-	-
	Shuma	24.96	449280				32,428

Konstatimi: Bashkia Kuçovë ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 4360.1 ha, i ndarë në 2 ekonomi pyjore dhe 2 ekonomi kullorë. Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, Bashkia e Kuçovës rezultoi se, nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore, nuk ka regjistruar asnjë sipërfaqe pyjore, nga 412 ngastra të transferuara nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ. Në bashkinë e Kuçovës janë lidhur 26 kontrata për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, nga të cilat 24 kontrata kanë si objekt aktiviteti “mbjellje bimësh” me afat 1 vjeçar me të drejtë rinovimi, ndërsa 2 kontrata kanë si objekt “mbarështimin e fidanëve” me afat 10 vjeçar, lidhur në vitin 2019. Nga auditimi rezultoi se për 26 kontrata të rinovuara në vitin 2023, qiraja vjetore për hektar është lidhur në vlerën 18000 lekë, dhe jo në vlerën 19,800 sipas çmimit të tarifave për dhënien në

shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore. Si pasojë, rezultojnë një diferencë nga të ardhurat për qiratë në fondin pyjor në vlerën 32,428 lekë. Kontratat e qirave nuk kanë ndjekur procedurën e konkurrimit publik (janë lidhur me kërkesa) si dhe nuk administrohen dosjet individuale ku të jetë përfshirë dokumentacioni si ekstrakti i regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë, planbiznes, etj.

Pika 2.4 e programit. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.

Për kryerjen e verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Kuçovë, dërguar me shkresë nr. 120/9 prot, datë 30.06.2023. Mbi auditimin e ushtruar në **Bashkinë Kuçovë**, sipas programit të auditimit nr. 360/1 prot, datë 13.03.2024, si një detyrim që buron nga kërkesat e Ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nga Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-it. Në zbatim të drejtimit nr. 4 “*Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm*” të programit të auditimit nr. 360/1 prot, datë 13.03.2024, nga audituesit e KLSH-së z. P.GJ dhe znj. E.K në prezencë të përfaqësuesit të subjektit të audituar Z. A.Ç, me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Auditit të Brendshëm, në cilësinë e koordinatorit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, u mbajt akt verifikimi nr.1, datë 12.04.2024.

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Bashkia Kuçovë me shkresë nr. 385/33 prot, datë 21.07.2023 **ka miratuar planin e veprimeve** për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, **brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, në përputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

- Bashkia Kuçovë në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, **ka përgatitur** planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve **brenda afatit 6 muajsh**, në përputhje me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua **mungesë e gjurmës së raportimit** në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH **me shkresë nr. 120/9 prot., datë 30.06.2023**, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej **73 rekomandime**, të cilat janë pranuar **73 plotësisht** ose në masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga **73** masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **24** prej tyre ose **32.88%**, zbatuar pjesërisht **2** masa ose **2.74%** e totalit të masave të pranuar, në proces zbatimi **4** masa ose **5.48%**, dhe pa zbatuar rezultuan **43** masa ose **58.90%**.

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve në auditimin paraardhës gjithsej **73 rekomandime** dërguar nga KLSH me shkresë nr. 120/9 prot., datë 30.06.2023 është si më poshtë :

36 masa organizative, nga të cilat 12 masa janë zbatuar plotësisht, **janë zbatuar pjesërisht 2 masa**, në proces zbatimi 1, **pa zbatuar 21 rekomandime**.

1 masë për shpërblim dëmi në shumën 1,512 mijë lekë, e pranuar plotësisht 1, dhe ka statusin e ne proces zbatimi 1.

10 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara) në shumën 137,684 mijë lekë, nga të cilat **10 masa** janë pranuar plotësisht, 2 masa në shumën 23,346 mijë lekë janë ne proces zbatimi, **8 masa** në shumën 114,338 mijë lekë janë pa zbatuar.

25 masë disiplinore, te pranuar plotësisht 25 masa, të cilat kanë statusin 12 masa janë zbatuar plotësisht dhe **13 masa janë pazbatuar**.

1 masë njoftimi Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil, e pranuar plotësisht, me status **1masë pazbatuar**.

Për të cilat **ri kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve në proces, si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

1.3.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të ngrejë grup pune për kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune dhe përshtatjen e rregullores me ndryshimet e ndodhura në strukturën e bashkisë.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Kuçovë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit mbi programet e trajnimit për zhvillimin profesional të stafit, mungesës plan-veprimi për MFK, mungesës për nxjerrjen e urdhrat për përmirësimin e Rregullores se brendshme e bashkisë, mungesës së “Hartës së proceseve të punës”, mungesa e menaxhimit dhe monitorimit të riskut, mungesa e përpjekjeve për ngritjen e sistemit informatik për të ardhurat rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

Statusi: Pazbatuar

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm, të marrë masa për:

-Certifikimin e audituesve të NJAB;

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2024

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kuçovë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

auditimit të brendshëm të njërive publike nuk ka arkivuar dosjet në arkivin e njësisë vendore; nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nuk ka vlerësuar nivelin e riskut në planifikimin vjetor auditimet e programuara për vitin 2023.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar pjesërisht*.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Nga Bashkia Kuçovë nuk u paraqit nuk u paraqiten analiza për shkeljet e konstatuara nga duke analizuar ato, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

8.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit riparimin e defekteve dhe mangësive të konstatuara.

Brenda 3 mujorit të tretë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion mbi njoftimin e kontraktorit mbi shkeljet e konstatuara, për marrjen e masave për rregullimin e tyre.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

9.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të ngrëjë një komision me përbërje të specialistëve të fushës, për përcaktimin e devijimeve në furnizimin e vendosjen e kaldajës në Shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi. Të trajtohen mundësitë e funksionimit me lëndë djegëse pellet, megjithëse kaldaja ishte parashikuar të funksiononte me naftë dhe të bëhet rivlerësimi i çmimit si pasojë e ndryshimit të teknologjisë.

Brenda 3 mujorit të tretë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Pa përgjigje nga Bashkia Kuçovë

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

10.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për parashikimin në planin e investimeve të masave mbrojtëse për skarpatat e kanalit të devijimit të përroit Gegë, me qëllim minimizimin e dëmeve dhe rritjen e kostos për ndërhyrje, si pasojë e dëmeve që mund të shkaktohen nga vërshimi i ujit, në raste të prurjeve të mëdha.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Pa përgjigje nga Bashkia Kuçovë

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

11.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t'i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me economicitet, efikasitet dhe efektivitet.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Pa përgjigje nga Bashkia Kuçovë

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

12.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t'i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

12.2.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë t'i kërkojë kontraktorit riparimin dhe pajisjen me kapakë të pushtave plastike, duke qenë se punimet janë në periudhën e riparimit të defekteve. Të merren masa për njoftimin e organeve kompetente për identifikimin e dëmtuesve dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme të infrastrukturës.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Pa përgjigje nga Bashkia Kuçovë

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

13.1.Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Pa përgjigje nga Bashkia Kuçovë

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

17.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rasti i subjektit Z.G.M u trajtua në rekomandimin nr.16.1. Nga bashkia Kuçove nuk u paraqit rast/te zbatimit te këtij rekomandimi, arsye për të cilën grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të *pranuar* nga subjekti dhe *pa zbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

18.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rasti i subjektit Z.G.M u trajtua në rekomandimin nr.16.1. Nga bashkia Kuçove nuk u paraqit rast/te reja zbatimit te këtij rekomandimi, arsye për të cilën grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të *pranuar* nga subjekti dhe *pa zbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

19.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, sipas Rregulloren e Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rasti i subjektit Z.G.M u trajtua në rekomandimin nr.16.1. Nga bashkia Kuçovë nuk u paraqit rast/te te reja zbatimit te këtij rekomandimi, arsye për të cilën grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të *pranuar* nga subjekti dhe *pa zbatuar*.

Statusi: Pa zbatuar

20.1.Rekomandimi:Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Nga Bashkia Kuçovë dokumentacioni i sipërpërmendur nuk është i mjaftueshëm për të treguar marrjen e masave nga institucionet përkatëse për të marrë miratime dhe të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të *pranuar* nga subjekti dhe *pa zbatuar*

Statusi: Pa zbatuar.

22.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi të mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa informon subjekti i audituar nuk evidentohet rasti i zbatimit të këtij rekomandimi, arsye për të cilën grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të *pranuar* nga subjekti dhe *pa zbatuar*

Statusi: Pa zbatuar

26.1.Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Kuçovë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Subjekti nuk paraqiti informacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti** dhe **pazbatuar**.

Statusi: Pazbatuar

27.1.Rekomandimi:Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Subjekti nuk paraqiti informacion dhe dokumentacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti** dhe **pazbatuar**.

Statusi: Pazbatuar

28.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Subjekti nuk paraqiti informacion dhe dokumentacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti** dhe **pazbatuar**.

Statusi: Pazbatuar

29.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Informacioni dhe dokumentacion i paraqitur nga subjekti, nuk tregon zbatimin e këtij e këtij rekomandimi, pasi nuk paraqet ka rast të ndërprerjes së punimeve për subjekte pa leje ndërtimit. Argumenti juaj nuk përputhet me këtë rekomandim.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti dhe pazbatuar**.

Statusi: Pazbatuar

30.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Informacioni dhe dokumentacion i paraqitur nga subjekti, nuk tregon zbatimin e këtij e këtij rekomandimi, pasi nuk ka asnjë tregues mbi përmirësimin regjistrimit të familjeve me tokë bujqësore, sipas të dhënave të ASHK.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti dhe pazbatuar**.

Statusi: Pazbatuar.

B.1. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej **22 rekomandime**, të cilat janë pranuar **plotësisht** ose në masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga **22** masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **7** prej tyre ose **31.82%**, në proces zbatimi **8** masa ose **36.36%** dhe pa zbatuar rezultuan **7** masa ose **31.82%**.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve **në auditimin paraardhës** për gjithsej **22 rekomandime** për përmirësimin e situatës, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022 është si më poshtë :

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18 masa** organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **7** janë zbatuar plotësisht, **5** masa në proces zbatimit dhe **6 nuk janë zbatuar**.

Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë **3 rekomandime** në vlerën 111,674 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, **3** masat janë në proces zbatimi.

1 masë disiplinore, e cila **nuk është zbatuar**;

Konkretisht **rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve në proces, si më poshtë vijon:

B.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit. Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Deri më 31.10.2024

Komenti i grupit të auditimit:

Pa informacion dhe dokumentacion nga subjekti audituar.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti dhe pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

1.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme, duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, si dhe të hartohet program për trajnimin dhe për ngritjen profesionale të stafit.

Deri më 31.10.2024

Komenti i grupit të auditimit:

Mungon Urdhër nga Titullari per përmirësimin e rregullores në fuqi.

Nuk u paraqit asnjë propozim per ndryshim ne rregullore.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga **subjekti** dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

8.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (ndërtesa e konstruksione), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje/ulje rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) “Aktive afatgjata materiale” e llog. (109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Gjithashtu të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asetëve të Bashkisë Kuçovë, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

Deri më 31.10.2024

Komenti i grupit të auditimit:

Nga subjekti audituar nuk u paraqit informacion dhe dokumentacion.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar nga subjekti** dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

9.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemin në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në “U SHA dhe 100% në kapitalin e aksioneve tek klub sport “N” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Sistemimi në kontabilitet dhe regjistrimin si pjesëmarrjes 34,68 % të kapitalin me vlerë monetare 304,073,000 lekë, në “U SHA, nuk mund te bëhet, pasi Bashkia Kuçove nuk është me aksionere në kapitalin e shoqërisë.

Regjistrimi 100% në kapitalin e aksioneve të sport klub “N” me vlerë 3,500,000 lekë, vazhdon të mos jetë pasqyruar në kontabilitet.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Kuçovë me specialist të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave. Gjithashtu DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa për përditësimin e të dhënave me dokumentacionin e nevojshëm, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

Deri më 31.10.2024

Komenti i grupit të auditimit:

Subjekti audituar nuk paraqiti informacion dhe dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

14.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, me shkresat nr. 98/17 datë. 14.09.2021 dhe shkresat nr. 678/35 datë. 05.08.2021, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të hartojë plan pune të veçantë për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht: a-Për 11 masa organizative, konkretisht sipas shkresës nr. 98/17 datë. 14.09.2021 rekomandimet nr. (1,2,3,4,11,12 dhe 13) dhe sipas shkresës nr. 678/35 datë. 05.08.2021 rekomandimet nr. (2,3,4 dhe 7); b-Për 6 masa shpërblim dëmi në vlerën 1,272

mijë lekë, për të gjitha pikat e rekomanduara; c- Për një masë në vlerën 358,448 mijë lekë për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-^{ve}, si dhe 1 masë në vlerën 13,527 mijë lekë të ardhura të munguara.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqiten analiza lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

C.1 Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare 21,717,246 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2.2.Rekomandimi: Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqit informacion dhe dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore listën me subjektet debitoare për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAV Bashkia Kuçovë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore, për arkëtimin e vlerës debitoare **prej 15,579 mijë lekë**.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqit informacion dhe dokumentacion mbi zbatimin e rekomandimit.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve.

4.2.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit Bashkia Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 1,500 mijë lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 534,934 lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Nga DAV nuk u paraqit nxjerrja e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, për të ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 534,934 lekë.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor UK Sh.A Berat –Kuçovë, për arkëtimin e tyre.

6.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 52,670 mijë lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Nga DAV nuk u paraqit informacion për nxjerrja e njoftim vlerësimit tatimor për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA;

Nga DAV nuk u paraqit informacion për procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat familjare prej 52,670 mijë lekë

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 22,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

Komenti i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk u paraqit informacion mbi marrjen e masave dhe procedurave e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 22,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

D. Masa disiplinore.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Kuçovë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**”, për:

1. **Z. S.L**, me detyrë Drejtor i DAV, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit)*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion mbi vlerësimin e përgjegjësive të punonjësit për mangësitë e konstatuara në Raportit të Auditimit.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

2. **Z. S.V** , me detyrë Drejtor i Transportit, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, si dhe procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (48-111) dhe (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi auditimit kërkoi vendimin e largimit të punonjësit, dhe rezultoi se me vendim nr. 37, date 13.10.2023 z. S.V emërohet Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Koordinim – Zhvillimit Strategjik.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **të pa zbatuar**.

Statusi: Pa Zbatuar

3. **Z. N.S** , me detyrë Drejtor i Zhvillimit Rural, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit)*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion mbi vlerësimin e përgjegjësive të punonjësit për mangësitë e konstatuara në Raportit të Auditimit.

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pranuar nga subjekti dhe pa zbatuar.

Statusi: Pa zbatuar

4. **Z. A.D** , me detyrë Kryeinspektori IVMT-së Kuçovë, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (125-133) të Raportit të Auditimit).*

Përgjigjja e institucionit:

Nuk është marre mase administrative

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

5. **Z. S.M** , me detyrë Drejtor i NSHP, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

6. **Zj. A.E** , me detyrë Specialist në Sektorin e Prokurimeve, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupit të auditimit ju paraqit vendimi nr. 39, datë 17.10.2023 për lëvizjen paralele të nëpunësës nga "Specialist prokurimesh" në "specialist i burimeve njerëzore".

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **të pazbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

7. **Z. A.P** , me detyrë Anëtar i NJP, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (48-111) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

8. **Znj. A.B** , me detyrë Specialist për Projektet, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (111-125) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

9. Z. J.L , me detyrë Inspektor i IVMT-së, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe procedurat e prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (48-111) dhe (2.5) faqe (111-125) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

10. Z. R.B , me detyrë Inspektor i IVMT-së Kuçovë, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (125-133) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

11. Z. F.D , me detyrë Administrator i NJA Kozare, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

12. Z. A.C , me detyrë Administrator i NJA Lumas, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

13. Znj. R.B , me detyrë Administrator i NJA Perondi, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (21-47) të Raportit të Auditimit).*

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar.

E. Njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Kuçovë, Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e konsideron rekomandimin **të pranuar** nga subjekti dhe **pa zbatuar**.

Statusi: Pa zbatuar

Për sa më lartë trajtuar, në situatën e mësipërme për mos marrjen e masave lidhur me zbatimin e rekomandimeve kanë përgjegjësi personat e përcaktuar në Plan Veprimi “Për zbatimin e

rekomandimeve ne raportin përfundimtar të KLSH-se me shkresë nr. 120/9 prot, datë 30.06.2023” miratuar nga Titullarit të Institucionit.

1. Z. **K.H** me detyrë Kryetar në Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Titullarit të Institucionit.
2. Anëtarët e GMS miratuar me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë nr. 118, datë 22.05.2023
3. Z. **A.C** , me detyrë Përgjegjës i Njesisë se Auditit te Brendshëm, si dhe në cilësinë e koordinatorit të ndjekjes se zbatimit të rekomandimeve.
4. Z. **H.SH** me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, në cilesinë e Nëpunësit Zbatues.
5. Z. **S.L** , me detyrë Drejtor i Drejtoria e te Ardhurave Lokale.
6. Z. **E.P** me detyrë Drejtor Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore
7. Z. **S.V** , me detyrë ish-Drejtoria e Transporteve, Shërbimeve Publike, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mjedisit, aktualisht Drejtori në Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe e Koordinimit-Zhvillimit Strategjik
8. Z. **N.S** , me detyrë Drejtor i Zhvillimit Rural.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 945/14 prot, datë 19.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 360/4 prot, datë 22.04.2024 prot, mbi zbatimin e rekomandimeve, nga Z.S.L , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Lidhur me planifikimin e taksave dhe tarifave për tokën bujqësore në shumën 13,056,000 lekë [**gjetje nga auditimi nr. 30**], e dhëna për vitin 2022 nuk përkon me vlerat e dhëna bazuar në kategorinë, sipërfaqen e tokës bujqësore, pasi nga ana jona (bashkia Kuçovë) i është gabim tabela grupit të auditimit të KLSH-së. Pas verifikimeve të bëra nga Sektori i Kadastrës në Nj.Ad përkatëse në varësi të Drejtorisë së Zhvillimit Rural tabela është korrigjuar (saktësuar). Vlerat e tabelës së korrigjuar përkojnë me vlerat e regjistrit që mbahet nga punonjësi i njesisë administrative përkatëse nga ku bëhet dhe faturimi. (bashkëlidhur tabelat).

2. Lidhur me planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar” [**gjetje nga auditimi nr.31**], ku citohet se janë taksuar 12.286 familje, ose 6.376 familje me pak se regjistri total i gjendjes civile. Për shkak të emigrimit masiv numri i familjeve rezidente për te cilat ofrohet shërbimi pastrim, ndriçim, gjelbërimit është më i vogël se numri i familjeve që janë regjistruar në gjendjen civile. Gjithashtu pasi kemi marre të dhënat nga sektori i shërbimit OSHEE dhe Ujësjellësit, duke kryqëzuar të dhënat për numrin e abonentëve që kanë kontratë për energjinë elektrike dhe me ujësjellësin, ky numër është i përafërt me numrin e familjeve të tarifuara. Familjet jo rezidente nuk përjashtohen nga taksa e përjashtohen nga taksa e pasurisë, por vetëm ato të parashikuara me ligj. Në lidhje me regjistrin e të dhënave për kategorinë “Familjarë”, Drejtoria e të Ardhurave disponon regjistër me të dhënat e marra nga Drejtoria e Planifikimit të territorit, nga sistemi “Protax” i Ministrisë së Financave, i cili përmban raportin e pronave të siguruara me censusin si dhe regjistri i marrë nga ASHK, nga kryqëzimi të cilave është krijuar regjistri për taksën e ndërtesës, i cili është në përditësim.

3. Lidhur me tarifën e ndotjes, po ju dërgojmë bashkëlidhur “Njoftim vlerësimin” e një nga 7 subjektet, që është dërguar datë 21.12.2023 me nr. 4,312 prot, si dhe listën e subjekteve dhe jemi në fillim të procesit të marrjes së masave shtrënguese.

4. Lidhur me marrjen e masave shtrënguese për arkëtimin e vlerës debitoare për “Familjarë”, nga Nj.Ad është bërë procedura e bllokimit bankar për debitorët më vlerë 20.000 lekë [bashkëlidhur procedura].

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

1. Lidhur me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se përgjigja e dhënë nga ju lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi ishte: -“Taksimi i familjeve me tokë bujqësore është bërë bazuar tek Printimi 3 dhe ndryshimet e pronësisë janë në rastin e shitjes ose brenda familjes kur prona kalon tek trashëgimtari”. Sipas dokumentacionit te grupit te auditimit, sipërfaqja e **tokës e ndare** me ligjin nr. 7501 date 19/07/1991 **ne të tre** Njësitë Administrative mbi te cilën llogariten te ardhurat **është 6,096 Ha**. Për tabelën me të dhëna të korrigjuara nga ju, grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi saktësinë e saj, pas

përfundimit të auditimit në terren, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2. Përgjigja juaj lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi ishte: Në bashkëpunim me Ujësllësin si agjent tatimor për Bashkinë Kuçovë në muajin Janar 2023 faturoheshin për taksa tarifa 5538 familje dhe në muajin Janar 2024 u faturuan 8241 familje. Regjistri me të dhënat për kategorinë “Familjarë”, sipas observacionit tuaj është në përditësim, e cila konvertohet në të ardhur të munguar për shkak të mos faturimit të taksës së pronësisë (ndërtesës), veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.106/2017 date 30.11.2017 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632 date 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, V.K.M nr. 132 date 07.03.2018 ”Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 945/11 prot, datë 18.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 360/2 prot, datë 22.04.2024 prot, mbi zbatimin e rekomandimeve, nga punonjësit e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në bashkinë Kuçovë kryeinspektor Z.A.D ,inspektor z. R.B , inspektor z. J.L , të cilët kanë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. **(gjetje nr. 1)** lidhur me zbatimin e rekomandimeve realizimi në terren jo në përputhje me lejet e ndërtimit më nr. 3933/1, dt 08.04.2020 me objekt “Ndërtim lokal shërbimi 1kt+ndërtim fushe futbollit”, me zhvillues z. R.Z dhe E.Z , me adresë fshati Tapi.

Ky objekt zhvillohet në pasurinë me nr. 140/18, zk3327. Me sipërfaqe totale 10000 m2. Në lidhje me lejen e përmendur për këtë zhvillim ju bëjmë me dije se është miratuar vetëm ndryshimi i planvendosjes për arsye të probleme të ndryshme teknike që kanë dalë gjatë zbatimit, si shkarje gjeologjike të pronës, ekzistenca e një tubi ujësllësi nëntokësor i cili doli pasi filluan punimet . IMT ka ndjekur të gjitha procedurat për zbatimin e kësaj leje ndërtimi, por nga ana e subjektit por nga ana e subjektit nuk është shfaqur interes për vazhdimin e procedurave të tjera. Nga IMT është bërë kontroll në këtë objekt me leje ndërtimi, dhe nuk ka shkelje të lejes. Në këto kushte nuk është detyrë e IVMT për marrjen e masave për mos vazhdimin e procedurës për marrjen e lejes së përdorimit.

2. **(gjetje nr. 2)** lidhur me zbatimin e rekomandimeve realizimin terren jo në përputhje me lejen e ndërtimit nr. 1420/1 prot, datë 10.05.2021, për “Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregëtim produktesh bujqësore 2 kt”, me zhvillues dhe aplikues E.B me adrese fshati Kozarë Kuçovë.

Për objektet e tjera të evidentuara në foton bashkëngjitur gjetjes nr. 2, ju bëjmë me dije se të gjitha janë objekte me leje dhe konkretisht:

1-Leje ndërtimi nr. 1157/1, dt 24.04.2020 “Ndërtim objekt për grumbullim, ruajtje dhe tregëtim produktesh bujqësore, 2kt”;

2-Leje ndërtimi nr. 1824/1, dt 26.06.2020 “Ndërtim magazinë për grumbullim, ruajtje dhe përpunim produktesh bujqësore dhe blegtorale”;

3- Deklaratë paraprake punimesh nr. 3603/1, dt 19.10.2020 “Ndërtim tende e çmontueshme”;

4- Deklaratë paraprake punimesh nr. 1513, dt 04.05.2021 “Ndërtim tende e çmontueshme”;

5- Deklaratë paraprake punimesh nr. 2576/1, dt 29.08.2022 “Ndërtim çatie e pashfrytëzueshme”;

Nga ana jonë është bërë kontrolli i këtyre lejeve dhe për shkeljen e konstatuar është marrë masa e dënimit me gjobe nr. 120, dt 04.11.2022 në shumën 300.000 leke dhe vendim prishje nr. 45, dt 04.11.2022.(bashkëngjitur lejet e marra nga ky zhvillues)

3. **(gjetje nr. 3)** lidhur me zbatimin e rekomandimeve realizimin terren jo në përputhje me lejen e ndërtimit nr. 1307/1 prot, datë 22.04.2022, për “Objekt për grumbullim, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, me zhvillues A.Q me adrese fshati Sheqëz, Kuçovë.

Për lejen e ndërtimit nr. 1307/1 prot, datë 22.04.2022 ju sqarojmë se kjo leje ndryshimi i gjurmës vjen si pasojë e vendosjes së një strehe (mbrojtëse nga shiu dhe dielli) në hyrjen kryesore të objektit dhe jo shtim volumi në lejen e dhënë.

4. **(gjetje nr. 4)** Mungese e deklaratës paraprake të punimeve për realizimin e objektit me konstruksion metalik në hapësirën publike.

Në bazë të kontratës ë lidhur të datës 29.10.2020, pika 6, subjekti taksapagues ka të drejtë sipas legjislacionit në fuqi të përdorë truallin e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

Qytetari ka bërë pagesën e truallit 68,664 lekë, ka paraqitur pranë bashkisë Kuçovë një kërkesës të protokollat me nr. 1201, dt 06.04.202, ku kërkon vendosjen e një pedanë druri dhe tende dielli. Nga ana e bashkisë me përgjigjen nr. 1201/1, dt 06.04.2021 i është kthyer përgjigje se për këto punime nuk ka nevojë për leje ndërtimi (bashkëlidhur dokumentacioni)

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Ne te tre rastet e lejeve të ndërtimit, të observuara nga subjekti i audituar, gjate auditimit në terren, sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar është konstatuar se ne 3 praktikat e sipërcituara u konstatua mungesë e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi. Rekomandimi i lenë nga KLSH ka synuar që nga DPZHT, bashkia Kuçovë të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe ato të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

Sa me sipër, përmbajtja e arsytimit në observacion nuk përputhet me përmbajtjen e rekomandimit të dhënë, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.945/17 prot, datë 29.05.2024 protokolluar në KLSH me nr. 360/6 prot, datë 31.05.2024 prot, nga Bashkia Kuçovë, ku janë shprehur objeksionet e për masat e marra në vitin 2024 për zbatimin e rekomandimeve të cilat subjekti ka filluar procedurën për zbatim por që bashkëlidhur objeksioneve nuk ka dokumenta bashkëlidhur që vërtetojnë marrjen e masave pra ky observacion ngelet me përgjigjen që është dhënë sa më sipër.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 “*Auditimi i jashtëm*”, pika 5, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 120/9 prot., datë 30.06.2023, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej 73 rekomandime, të cilat janë pranuar 73 plotësisht ose ne masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga 73 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 24 prej tyre ose 32.88%, zbatuar pjesërisht 2 masa ose 2.74% e totalit të masave të pranuar, në proces zbatimi 4 masa ose 5.48%, dhe pa zbatuar rezultuan 43 masa ose 58.90%.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej 22 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht ose ne masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga 22 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 7 prej tyre ose 31.82%, në proces zbatimi 8 masa ose 36.36% dhe pa zbatuar rezultuan 7 masa ose 31.82%.

IV. GJETJE DHE PËR KËTË REKOMANDOJMË

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm janë konstatuar mangësi në 5 komponentët si:

“Mjedisi i Kontrollit”: Për vitin 2023 nuk ka patur plan-veprimi për MFK si dhe mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Nga ana formale, rregulloja ka vetëm firmën e Kryetarit dhe vulën e institucionit, por nuk ka numër protokollit dhe nuk është e miratuar në Këshillin Bashkiak. Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën organizative.

“Menaxhimi i Riskut”: Bashkia Kuçovë nuk ka ngritur grupin e menaxhimit të riskut, përfshirë koordinatoren si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar).

“Aktivitetet e Kontrollit”: Bashkia Kuçovë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar infrastrukturën IT në proceset e punës të sektorëve të ndryshëm.

“Informimi dhe Komunikimi”: Është konstatuar se në faqen ueb të Bashkisë Kuçovë mungojnë publikimet e buxhetit për vitin 2023; kalendari vjetor i dëgjësive publike; raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2023.

“Monitorimi dhe Raportimi”: Në Bashkinë Kuçovë mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të re për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë, ku objektivat institucionale të përcaktuara të jenë në përputhje me ndarjen e detyrave për çdo drejtori apo sektor. Në veçanti, të krijohet grupi i menaxhimit të riskut dhe të hartohet një plan menaxhimi i posaçëm, ku të jetë i integruar risku i mashtrimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kuçovë, rezultoi se nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në auditimet e kryera për vitin 2023, konstatohet se Sektori i Auditit të Brendshëm (AB) nuk ka kryer auditime me bazë risku, duke planifikuar auditime për sektorin e prokurimeve si dhe nuk ka ndjekur zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje nenin 6, nenin 11, nenin 12, nenin 14 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 12-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore. Në veçanti, të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve duke kryer për këtë qëllim auditime të posaçme.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Totali i detyrimeve të pa likuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 16,457 mijë lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 654,423 mijë lekë zënë 2.51%, kjo e raportuar në MFE me shkresën nr. 728 prot., datë 22.02.2024. Nga auditimi ka rezultuar se nuk janë raportuar si detyrime të vitit 2023 detyrimet për vlerën 15,442,402 lekë që i përkasin subjekteve (“B ” shpk për faturën nr. 65, datë 06.11.2023 për vlerën 10,186,960 lekë dhe subjektit “B ” shpk për faturë nr. 25, datë 01.09.2023 për vlerën 5,357,442 lekë), të cilave i ka kaluar afati 60 ditore, këto detyrime janë raportuar në vitin 2024 sipas Urdhër regjistrimit nr. 5 dhe 6, datë 21.03.2024, veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues të MFE nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 126.1 Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, germa “a” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kuçovë, të marrë masa që stokun e detyrimeve të prapambetura ta raportojë sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara me qëllim planifikimin për shlyerjen e tyre në buxhetin viti pasardhës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 166,758,021 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se në kredi të

llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve për vlerën 23,447,723 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kuçovë, të kontabilizojë vlerën prej 23,447,723 lekë si e ardhur e munguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e debitorëve.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime dhe projekte”, konstatohet se, kjo llogari është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 6,235,200 lekë, projekt i vënë në zbatim për objektin “Rikonstruksion i rrugës Kuçovë-Ura Vajgurore” gjithashtu në këtë llogari vlera prej 1,359,400 lekë është e pa analizuar dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kuçovë, për projekte të cilat janë vënë në zbatim dhe për ato të cilat janë të pa analizuar, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 163,166,636 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, është kontabilizuar gabim vlera prej 7,992,306 lekë për sistemim varrezash që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 210 “Toka,troje Terrene” gjithashtu në këtë llogari nuk është zbritur vlera për 7 ndërtesa ambulanca në fshatrat Demollar, Perondi, Tapi, Goraj dhe Magjat në vlerën 3,857,909 lekë që janë objekte të cilat i përkasin DRSHSH, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kuçovë, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe të bëjë sistemimet përkatëse në llogaritë 210 “*Toka, troje Terrene*” dhe llogarinë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” sipas Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 747,461,215 lekë dhe në vitin 2023 në vlerën 884,316,342 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera për 2 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në vlerën 28,866,405 lekë (KUZ lagja 11 janari në vlerën 9,751,014 lekë dhe KUZ lagja 1 maji në vlerën 19,115,391 lekë) që janë transferuar UK Kuçovë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a të 2 artikujve kontabël pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 28,866,405 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga 3504 prona të transferuara me VKM, një pjesë e konsiderueshme prej 3372 nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe Pasqyrën e Pozicionit Financiar “Aktivet afatgjata material”, Gjithashtu ka rezultuar se nga 186 objekte inventari të pasurive të paluajtshme, Bashkia Kuçovë për 4 objekte janë pajisur me titull pronësie, ndërsa për 182 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Kuçovë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, Bashkia nuk ka ndërmarrë procedurë sipas përcaktimeve të ligjit nr 79/2017 “Për sportin” ndryshuar me ligjin nr 105 “Për sportin”, datë 29.07.2020 neni 22, ku përcaktohet.....pika 1. Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e

përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pika 2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare. Për sa kohë që nuk është shitur duhet që në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” të pasqyrohet 100% në kapitalin e aksioneve tek Klub Sport “N ” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të bëjë saktësimin e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, duke pasqyruar në kontabilitet vlerën prej 3,500,000 lekë pjesë e aksioneve tek Klub Sport “N”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 483,149,045 lekë, në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se për vitin 2023 ka kontrata që kanë përfunduar si punime të cilat duhej të kapitalizoheshin në llogaritë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për objektin “ Ndërtim Ujësjiellësi në fshatrat Lumas etj ” në vlerën 426,976,583 lekë, pra vlera e llogarie 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, është raportuar e mbivlerësuar pra nuk është kryer veprimi kontabëlizimit në grupin 20 e 21 të aktiveve të përfunduara, veprime në kundërshtim Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Aneksi 1, Klasa 23 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Kuçovë, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është pasqyruar në vlerën 27,067,903 lekë nga auditimi ka rezultuar se nuk janë evidentuar si detyrime të pa likuiduara vlera prej 15,442,402 lekë, që i përkasin faturës nr. 65, datë 06.11.2023 për vlerën 10,186,960 lekë e operatorit “B ” shpk për kontratë nr 193, datë 08.06.2023 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Havakleas” dhe faturë nr 25, datë 01.09.2023 për vlerën 5,357,442 lekë e operatorit “B ” shpk për kontratë nr 545, datë 10.02.2023 “Rikualifikim i sheshit të Kombinatit”. Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për kryerje investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2023, për vlerën 15,442,402 lekë, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve, veprime në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit, të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

12. Gjetje nga auditimi: Në total, nga 3504 prona që i janë transferuar në pronësi Bashkisë Kuçovë, përfshirë ish-komunat (Perondi, Kozare dhe Lumas), vetëm 118 pasuri janë regjistruar. Në veçanti konstatohet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to janë realizuar investime përgjatë viteve. Si rrjedhojë, inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kuçovë nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Nga Bashkia Kuçovë nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara në këtë drejtim. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 51-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronës. Në veçanti, të përcaktojë si prioritet regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shërbimeve arsimore, si shkolla dhe çerdhe.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë ka në administrim një fond pyjor dhe kullësor prej 4360.1 ha, i ndarë në 2 ekonomi pyjore dhe 2 ekonomi kullësore. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë detyrimet në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, ku është konstatuar se, nuk janë hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore, nuk është regjistruar asnjë sipërfaqe pyjore, nga 412 ngastra të transferuara dhe nuk është ngritur dhe përditësuar regjistri për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”; VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,” të ndryshuar; VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullësor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 51-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa që të parashikojë fonde për miratimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore si dhe për regjistrimin e sipërfaqeve pyjore, duke përditësuar edhe sistemin elektronik kadastral të pyjeve Alfis.

Në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 niveli i realizimit të të ardhurave në Bashkinë Kuçovë rezultoi në masën 93.29% (*pa përfshirë zërin sponsorizime dhe grante*) ose me mosrealizim prej 15,120 mijë lekë, duke sjellë diferencë ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta. Mos realizimi të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë. Këto veprime janë kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kuçovë miratuar me VKB nr. 79, date 22.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne VKB nr. 73, datë 30.11.2022, “Për Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2023 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Lokale në Bashkinë Kuçovë, të marrë e masa për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, duke synuar realizimin e të ardhurave të veta si burim financimi për shpenzimet e planifikuara.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 “Auditimi i jashtëm”, pika 5, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr. 120/9 prot., datë 30.06.2023, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej **73 rekomandime**, të cilat janë pranuar 73 plotësisht ose ne masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga 73 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 24 prej tyre ose 32.88%, zbatuar pjesërisht 2 masa ose 2.74% e totalit të masave të pranuar, në proces zbatimi 4 masa ose 5.48%, dhe **pa zbatuar rezultuan 43 masa ose 58.90%**, e detajuar:

36 masa organizative, nga të cilat 12 masa janë zbatuar plotësisht, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, në proces zbatimi 1, pa zbatuar 21 rekomandime.

1 masë për shpërblim dëmi në shumën 1,512 mijë lekë, e pranuar plotësisht 1, dhe ka statusin e ne proces zbatimi 1,

10 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (të ardhura të munguara) në shumën 137,684 mijë lekë, nga të cilat **10 masa** janë pranuar plotësisht, 2 masa në shumën 23,346 mijë lekë janë ne proces zbatimi, **8 masa** në shumën 114,338 mijë lekë janë pa zbatuar.

25 masë disiplinore, te pranuar plotësisht 25 masa, të cilat kanë statusin 12 masa janë zbatuar plotësisht dhe **13 masa** janë pazbatuar.

1 masë njoftimi Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil, e pranuar plotësisht, me status **1masë pazbatuar** .

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej 22 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht ose ne masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga 22 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 7 prej tyre ose 31.82%, në proces zbatimi 8 masa ose 36.36% dhe **pa zbatuar rezultuan 7 masa ose 31.82%** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masa organizative.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

1.3.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të ngrejë grup pune për kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit, me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune dhe përshtatjen e rregullores me ndryshimet e ndodhura në strukturën e bashkisë.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Kuçovë.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditit të Brendshëm, të marrë masa për:

-Certifikimin e audituesve të NJAB;

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kuçovë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësive vendore në arritjen e objektivave institucional.

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kritereve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit riparimin e defekteve dhe mangësive të konstatuara.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të ngrejë një komision me përbërje të specialistëve të fushës, për përcaktimin e devijimeve në furnizimin e vendosjen e kaldajës në Shkollën 9 vjeçare Fshati Tapi. Të trajtohen mundësitë e funksionimit me lëndë djegëse pellet, megjithëse kaldaja ishte parashikuar të funksiononte me naftë dhe të bëhet rivlerësimi i çmimit si pasojë e ndryshimit të teknologjisë.

10.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për parashikimin në planin e investimeve të masave mbrojtëse për skarpatat e kanalit të devijimit të përroit Gegë, me qëllim minimizimin e dëmeve dhe rritjen e kostos për ndërhyrje, si pasojë e dëmeve që mund të shkaktohen nga vërshimi i ujit, në raste të prurjeve të mëdha.

11.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t'i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet.

12.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë në investimet në vazhdimësi dhe në të ardhmen, t'i kushtojë rëndësi të veçantë monitorimit të kontratave, me synim arritjen e parametrave të parashikuara dhe realizim të investimeve me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet.

12.2.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë t'i kërkojë kontraktorit riparimin dhe pajisjen me kapakë të pusëve plastike, duke qenë se punimet janë në periudhën e riparimit të defekteve. Të merren masa për njoftimin e organeve kompetente për identifikimin e dëmtuesve dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme të infrastrukturës.

13.1.Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kuçovë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kritereve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

17.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

18.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

19.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Detajuar Vendor, sipas Rregulloren e Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

20.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe të jenë të ngarkuara edhe në sistemin e-leje gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

22.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Kuçovë të merren masa që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi të mos lejohen aplikime të cilat nuk janë në përputhje me kategorinë përkatëse dhe dokumentacioni për aplikimin e lejes së ndërtimit të jetë i plotë.

26.1.Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Kuçovë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

27.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

28.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

29.1.Rekomandimi: Nga IVMT Kuçovë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

30.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej **22 rekomandime**, të cilat janë pranuar **plotësisht** ose në masën 100%. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezultoi se nga **22** masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **7** prej tyre ose **31.82%**, në proces zbatimi **8** masa ose **36.36%** dhe pa zbatuar rezultuan **7** masa ose **31.82%**.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve **në auditimin paraardhës** për gjithsej **22 rekomandime** për përmirësimin e situatës, dërguar nga KLSH me shkresë nr.683/26 prot, datë 23.05.2022 është si më poshtë :

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18 masa** organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **7** janë zbatuar plotësisht, **5** masa në proces zbatimit dhe **6 nuk janë zbatuar**.

Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë **3 rekomandime** në vlerën 111,674 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, **3** masat janë në proces zbatimi.

1 masë disiplinore, e cila **nuk është zbatuar**;

1.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit. Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

1.2. Rekomandim: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme, duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, si dhe të hartohet program për trajnimin dhe për ngritjen profesionale të stafit.

8.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (ndërtesa e konstruksione), pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje/ulje rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse (21) "Aktive afatgjata materiale" e llog. (109) "Diferenca nga rivlerësimi".

